



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2023)

Pika 1 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatit z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
11. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.**
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashinë.**
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.**
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.**
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).**
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.**
- 7. Vladimir Karaj, BIRN.**

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatit z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Naureda Llagami: Përshëndetje!

Po fillojmë mbledhjen e radhës, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të datës 13 shtator.

Siç jeni në dijeni, në rendin e ditës janë 10 akte dhe është shtuar, ashtu siç jeni në dijeni, edhe një akt tjetër që ka të bëjë me caktimin e gjyqtarëve në gjykatat në nevojë.

Pa humbur kohë fillojmë me çështjen e parë të rendit të ditës që ka të bëjë me propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatit z. {...}, akt i cili është përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do relatohet nga z. Kurushi.

Klodian Kurushi: Faleminderit znj. Kryetare!

Meqenëse po bëjmë pas pushimeve mbledhjen e parë plenare bashkërisht, ju uroj kolegëve një vijim të mbarë të veprimtarisë së tyre si anëtar.

Pa humbur kohë po vijojmë më tej me relacionin e përgatitur që ka për objekt propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatit z. {...}.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor, nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuara nga ligji, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të gjitha niveleve, në kuadër të plotësimit të pozicioneve të lira në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, ndër të tjera, ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë edhe për një pozicion të lirë, në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e tij nr. 537, datë 17.11.2021.

Në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë (të përmendur më lart), afati i kandidimit u përcaktua “deri më datë 17.12.2021”. Ky vendim u publikua në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor më datë 17.11.2021, krahas edhe një njoftimi tjetër publik.

Kandidimet – Brenda afatit të parashikuar në vendimin e cituar më lart, në procedurën e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, shpallur me vendimin nr. 537, kandiduan gjithsej 5 (pesë) kandidatë dhe konkretisht: znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; z. {...} dhe z. {...}.

Me dekretin nr.78, datë 06.06.2023 Presidenti i Republikës ka emëruar znj. {...} gjyqtare të Gjykatës së Lartë.

Me dekretin nr.185, datë 03.08.2023 Presidenti i Republikës ka emëruar znj. {...} gjyqtare të Gjykatës së Lartë.

Procedurat e verifikimit - Procedura e verifikimit të plotësimit të kriterëve të kandidimit nga kandidatët për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e mësipërm, filloi me vendimin e KLGJ-së nr. 26, datë 17.01.2022.

Sikundër u përmend më lart, procedurat e verifikimit filluan me verifikimin e përvojës profesionale, mospasjes së masës disiplinore, mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale.

Në përfundim të procedurës së verifikimit paraprak të tre kriterëve formale të kandidimit, Këshilli konstatoi dhe vlerësoi plotësimin nga 4 (katër) kandidatët të këtyre kriterëve, duke vendosur vijimin e procedurës së verifikimit për kriteret e tjera ligjore të kandidimit. Për kandidatin {...}, me vendimin nr. 50, datë 08.02.2022, Këshilli vendosi skualifikimin dhe përjashtimin e tij nga procedurat e emërimit në Gjykatën e Lartë, pasi për të u verifikua mosplotësimi i kriterit të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”.

Konkretisht, verifikimi i plotësimit nga kandidatët të tre kritereve formale të kandidimit, u vendos nga Këshilli: me vendimin nr. 130, datë 06.04.2022 për kandidaten znj. {...}; me vendimin nr. 129, datë 06.04.2022 për kandidaten znj. {...}; me vendimin nr. 96, datë 09.03.2022 për kandidatin z. {...}; me vendimin nr. 105, datë 25.03.2022 për kandidaten znj. {...}.

Në vijim, Këshilli verifikoi plotësimin nga secili prej katër kandidatëve të tjerë edhe të kritereve “të pasurisë dhe figurës”, sipas pikave 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit për Statusin.

Në përfundim të procedurës së verifikimit, Këshilli konstatoi dhe vlerësoi plotësimin nga të katër kandidatët e tjerë të të gjithë kritereve të kandidimit, duke vendosur kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë.

Konkretisht, kualifikimi i katër kandidatëve dhe vijimi për ata të procedurës së ngritjes në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë, u vendos nga Këshilli:

- a) me vendimin nr. 129, datë 06.04.2022, për kandidaten znj. {...};
- b) me vendimin nr. 174, datë 05.05.2022, për kandidatin z. {...};
- c) me vendimin nr. 175, datë 05.05.2022, për kandidaten znj. {...};
- ç) me vendimin nr. 130, datë 06.04.2022, për kandidaten znj. {...}.

Procedurat e vlerësimit etik dhe profesional – 1) Procedura e vlerësimit me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013–2016 (periudhën e rivlerësimit kalimtar), referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin, filloi me vendimin e Këshillit nr. 198, datë 11.06.2020; 2) Procedura e vlerësimit të përshpejtuar për vitin 2021 për 3 nga kandidatët, referuar pikës 3, të nenit 25, “Dispozitë kalimtare”, shtuar në këtë ligj me Ligjin nr.48/2019 [...].

Në përfundim të procedurave të vlerësimit etik dhe profesional, Këshilli miratoi për secilin nga katër kandidatët e kualifikuar, vlerësimet etike dhe profesionale për periudhat respektive:

- a) për znj. {...}, janë vendimet nr. 536 dhe nr. 537, të vitit 2022;
- b) për kandidaten znj. {...} (në atë kohë), janë vendimet e Këshillit nr. 4 dhe nr. 161, të vitit 2023.

c) për kandidatin z. {...}, janë vendimet nr. 456, të vitit 2022 dhe nr.3, të vitit 2023;

ç) për kandidatën znj. {...}, janë vendimet nr. 119 dhe nr. 230, të vitit 2023.

Procedurat e përzgjedhjes - Ndërsa procedurat e vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve vijonin, për përfundimin në kohë të procedurës tërësore të ngritjes në detyrë, propozimit për emërim në Gjykatën e Lartë, edhe për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e tij nr. 537, datë 17.11.2021, Këshilli filloi procedurën e përzgjedhjes së kandidatëve me vendimin nr. 193, datë 27.05.2022.

Në përfundim të procedurës së përzgjedhjes, Këshilli vendosi këtë renditje për kandidatët:

1) Znj. {...};

2) Z. {...};

3) Znj. {...}

Pika e dytë e këtij vendimi “2. Propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 537, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të kandidatit z. {...}.”

Vendimi sipas pikës 18, të këtij vendimi, iu njoftua rregullisht, kandidatëve znj. {...}, z. {...} dhe znj. {...}, të cilët, bazuar në pikën 12, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, gëzonin të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi, brenda 5 ditëve, nga njoftimi i tij.

Kandidatja znj. {...} ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të mësipërm, duke paraqitur padi pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Pas shqyrtimit të padisë së paraqitur nga kandidatja znj. {...}, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. 164, datë 28.07.2023 vendosi rrëzimin e padisë.

Sipas informacionit të përcjellë nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, ka rezultuar se kandidatët tjerë z. {...} dhe znj. {...} nuk kanë ushtruar ankim ndaj vendimit paraprak të propozimit për emërim nr. 316, datë 14.06.2023. Në kushtet si më lart, vendimi paraprak i propozimit për emërim nr. 316, datë 14.06.2023, ka marrë formë të prerë me datë 14.07.2023.

Mbi plotësimin e kriterëve të kandidimit/emërimit në Gjykatën e Lartë, të kandidatit z. {...}

Siç u parashtrua, plotësimi i kriterëve të kandidimit nga kandidati z. {...}, u verifikua nga Këshilli me vendimin nr. 96, datë 09.03.2022.

Konkretisht, për kandidatin z. {...} është verifikuar plotësimi i kriterit (kushtit) të “përvojës minimale profesionale”. Për verifikimin e këtij kriteri janë administruar shkresat e datës 27.01.2022, e datës 02.02.2022 të Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor; shkresa e datës 10.02.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe shkresa e datës 03.02.2022 e Gjykatës së Apelit Durrës.

Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidati plotëson kriterin e përvojës së përgjithshme minimale profesionale, ndërsa ai ka ushtruar funksionin e gjyqtarës për më shumë se 13 vjet. Kandidati z. {...}, pas përfundimit të studimeve të larta për drejtësi, është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Me vendimin nr. {...}, datë 01.07.1992 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, emërohet gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan. Me vendimin nr. {...}, datë 20.10.1993 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, emërohet kryetar i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd. Me vendimin nr. {...}, datë 30.03.1995 emërohet kryetar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, dhe me dekretin e Presidentit të Republikës nr. {...}, datë 02.04.2001 është emëruar gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Durrës, ku vazhdon aktualisht funksionin. Gjithashtu, nga viti 2012 deri në vitin 2016 ka qenë anëtar i Kolegjit Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Po për kriterin e “përvojës minimale profesionale”, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidati plotëson edhe përvojën specifike minimale profesionale, ndërsa ai ka ushtruar funksionin e gjyqtarit në fushën e të drejtës civile për më shumë se 5 vjet. Përvojën specifike profesionale kandidati e ka në të tre gjykatat ku ka ushtruar funksionin e gjyqtarit.

Për kandidatin z. {...} është verifikuar plotësimi edhe i kriterit të “mospasjes masë disiplinore në fuqi”. Për verifikimin e këtij kriteri janë administruar shkresa e datës 27.01.2022, e Departamentit të Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Administrative pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Formulari i Vetëdeklarimit “Për masa disiplinore”, datë 03.12.2021, depozituar nga kandidat, nga ku ka rezultuar se nuk rezulton që ai të ketë masë disiplinore në fuqi.

Për kandidatin z. {...} është verifikuar plotësimi edhe i kriterit të “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”. Për verifikimin e këtij kriteri është administruar Formulari i Vetëdeklarimit “Për situatën e papajtueshmërisë ambientale”, datë 03.12.2021, depozituar nga kandidati në momentin e kandidimit, ku ai ka deklaruar se “Nuk do të ndodhem në situatën e papajtueshmërisë ambientale sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin”.

Për këtë kriter, nga të dhënat e rezultuara nga dokumentacioni i administruar është konstatuar se kandidati nuk do të ndodhej në situatën e papajtueshmërisë ambientale, sipas pikës 3, të nenit 8, të Ligjit për Statusin, nëse do të ngrihej në detyrë/emërohej në Gjykatën e Lartë.

Për kandidatin z. {...} është verifikuar plotësimi edhe i kriterëve të “pasurisë” dhe të “figurës”, nga ku ka rezultuar se është marrë vendim përkatës për kualifikimin e tij pasi është bërë verifikimi i pasurisë dhe figurës.

Në vijim, për kriteret e përmendura më lart, duke iu referuar figurës, në fund fare, në kushtet kur kandidati ka qenë gjyqtar magjistrat në detyrë në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, i ndryshuar, në përputhje me detyrimet e përcaktuara nga ky ligj, kandidati i është verifikuar dhe është nënshtruar edhe këtij verifikimi. Struktura e posaçme për regjistrimin, administrimin dhe përpunimin e formularëve të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit të përmendur më lart, me shkresën e datës 03.03.2022, ka konfirmuar se:

- kandidati ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit;
- formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare;
- në formularin e vetëdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji [...].

Në këtë pikë, e thamë, bëmë verifikimin e pasurisë dhe figurës dhe ka rezultuar që kandidati ka kaluar edhe këtë pjesën duke u kualifikuar për më tej.

Shqyrtimi nga ana e Komisionit – Në mbledhjen e Komisionit të datës 07.09.2023, pasi është shqyrtuar edhe kjo çështje, arrihet në konkluzionin se procedura e ndjekur është e plotë dhe t’i përcillet mbledhjes së Këshillit të Lartë Gjyqësor për të vlerësuar kjo e fundit se kandidati z. {...}, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës

civile, të shpallur me Vendimin e tij nr. 537, datë 17.11.2021 duhet t'i propozohet Presidentit të Republikës për t'u emëruar gjyqtar në Gjykatën e Lartë.

Struktura e vendimit - Projektvendimi është strukturuar në dy pika.

Në pikën e parë parashikohet t'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatit z. {...}.

Pika e dytë ka parashikimin në lidhje me detyrimin për njoftim të këtij vendimi dhe konkretisht parashikohet se një kopje e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Gjithashtu së fundmi, parashikohet se ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime nga kolegët, i ftoj ato që të kalojmë në votimin e projekt-aktit. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. T'i propozojë Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatit z. {...}.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 1 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2023)

Pika 2 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, shpenzime korrente, për vitin buxhetor 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
- 3. Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
- 4. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 5. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 6. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
- 7. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 8. Vladimir Karaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, shpenzime korrente, për vitin buxhetor 2023”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek çështja e dytë që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit mbi rishpërndarjen (transferimin) e fondeve buxhetore në programin 03310, shpenzime korrente, për vitin buxhetor 2023, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Për më shumë detaje ne kemi ftuar Drejtorin e Departamentit të Administrimit të Buxhetit, z. Xhevdet Haxhiu, i cili do të relatojë shkurtimisht projekt-aktin.

Xhevdet Haxhiu: Faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Sikurse jeni në dijeni, me ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, është miratuar buxheti për sistemin gjyqësor (grupi buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor), në shumën 4,362,600 mijë lekë, i ndarë në tre programe buxhetore, programi 01110, “Planifikim, Menaxhim dhe Administrim”, programi 01140, “Mbështetje për teknologjinë e sistemit të drejtësisë”, dhe programi 03310, “Buxheti Gjyqësor”.

Fondet buxhetore të miratuara për vitin 2023, në programin 03310, janë miratuar dhe detajuar në shumën prej 4,025,000 mijë lekë, (e ndarë respektivisht në shpenzime page, shpenzime sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe shpenzime kapitale).

Gjatë këtij viti buxhetor Këshilli i Lartë Gjyqësor, ka miratuar rishpërndarjen e fondeve buxhetore në shpenzime korrente, për shkak të përfundimit të zbatimit të hartës së re gjyqësore, atë të riorganizimit të gjykatave të apelit, ristrukturimit të gjykatave të rretheve gjyqësore dhe të gjykatave administrative të shkallës së parë.

Në maj këtij viti, si rezultat i ndryshimeve ligjore dhe nënligjore, ndryshoi edhe elementi i pagës referuese bazë për funksionet gjyqësore si dhe niveli i pagave për administratën gjyqësore dhe punonjësit e tjerë gjyqësorë.

Kështu me ligjin nr. 33/2023, “Për një ndryshim në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ndryshoi paga referuese bazë për funksionet gjyqësore dhe të prokurorisë, e cila është e njëjtë me shumëzimin e koeficientit 0.36 me pagën e Presidentit të Republikës.

Në zbatim të këtij ndryshimi ligjor, Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 437, datë 19.07.2023, ka vendosur që në buxhetin e miratuar për vitin 2023, për institucionin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të shtojë fondin prej 300,000 mijë lekësh, për përballimin e efekteve financiare nga data 1 prill 2023, deri në 31 dhjetor 2023, sipas përcaktimit ligjor të pagës referuese bazë të magjistratit, në zërin buxhetor “Shpenzime personeli”.

Gjithashtu, me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 31.05.2023 dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 31.05.2023, siç e citova më sipër ka ndryshuar edhe struktura e nivelit të pagave në administratën publike dhe për punonjësit e tjerë në disa institucione të administratës publike. Si rezultat i tyre është rritur paga e nëpunësve civilë në KLGJ, e nëpunësve civilë gjyqësorë në gjykata si dhe e punonjësve mbështetës në KLGJ dhe gjykata.

Në zbatim të këtyre ndryshimeve, Ministria e Financave dhe Ekomomisë, ka akorduar një fond shtesë prej 170,000 mijë lekë në zërin “Shpenzime personeli”, e ndarë kjo sipas programeve buxhetore (01110 – Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe 03310 – Buxheti Gjyqësor).

Gjithashtu nga analiza e bërë nga departamenti, si rezultat i mbylljes së fashës së tretë të riorganizimit të gjykatave, rezultojnë fonde të papërdorura, në shpenzime korrente në shumën 2 milion lekë (këto konsistojnë në shpenzime paga, në shpënzime sigurime shoqërore, në shpenzime operative dhe në shpenzime për transferta familjare), për të cilat propozojmë të transferohen pranë KLGJ, programi 03310.

Nga struktura përgjegjëse për administrimin e buxhetit pranë KLGJ, në bashkëpunim me gjykatat e të gjitha nivele, bëri një analizë të situatës buxhetore duke evidentuar nevojat për fonde shtesë si rezultat i ndryshimeve të mësipërme të cituara, si në pagën referuese bazë për magjistratët (gjyqtarë) ashtu edhe niveli i pagave për administratën gjyqësore dhe punonjësit e tjerë gjyqësorë, ku si rezultat i kësaj analize rezultoi e domosdoshme rishpërndarja e fondeve buxhetore në shpenzime korrente, për të bërë të mundur përballimin e këtij efekti financiar.

Për sa më sipër, në zbatim të legjislacionit për menaxhimin buxhetor, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozon seancës plenare të KLGJ-së, shqyrtimin dhe miratimin e relacionit mbi rishpërndarjen e fondeve buxhetore, programi 03310 “Buxheti gjyqësor”, në shpenzime korrente (600, 601, 602, 606) për vitin buxhetor 2023, në nivel programi, artikulli dhe njësie shpenzuese, sipas pasqyrave nr. 1, dhe nr. 2, bashkëlidhur.

Duke ju falënderuar, në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Ftoj kolegët nëse kanë ndonjë pyetje apo një kujtesë për t’i bërë drejtorisë.

Atëherë, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e rishpërndarjes (transferimit) të fondeve buxhetore, në programin 03310 “Buxheti gjyqësor”, në shpenzime korrente (600, 601, 602, 606), për vitin buxhetor 2023, sipas pasqyrave nr. 1, dhe nr. 2, bashkëlidhur.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 2 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2023)

Pika 3 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa automjeteve (autovetura), në sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
11. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor i Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
4. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
5. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
6. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
7. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
8. *Vladimir Karaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Mbi rishpërndarjen (transferimin) e disa automjeteve (autovetura), në sistemin gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit.

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që edhe ky është projekt-akt i Komisionit të Administrimit të Buxhetit që ka të bëjë me rishpërndarjen (transferimin) e disa automjeteve (autovetura), në sistemin gjyqësor. Për më shumë detaje prapë ia jap fjalën drejtorit.

Xhevdet Haxhiu: Edhe një herë faleminderit Kryetare!

Të nderuar anëtarë!

Gjatë vitit buxhetor 2023, u realizua procedura e blerjes së 10 (dhjetë) copë automjeteve, për nevojat e sistemit gjyqësor, të tipit Sedan, Scoda Octavia 2.00, të cilat janë marrë në dorëzim dhe janë bërë hyrje në magazinën e KLGJ-së.

Gjatë përgatitjes së PBA 2023 – 2025, paraqitën kërkesa për automjete, Gjykata e Lartë, Gjykata Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër, Durrës dhe Vlorë si dhe gjykatat e

posaçme. Kjo e fundit, po gjatë vitit 2023, në rishpërndarjen që iu bë automjeteve si rezultat i hartës, përfituan 4 automjete.

Gjatë vitit 2023, një pjesë e këtyre kërkesave të mësipërme u plotësuan me rishpërndarjen e automjeteve në gjykatat e apeleve, në gjykatat e rretheve gjyqësore dhe gjykatave administrative të cilat mbyllën.

Në Gjykatën e Lartë u transferuan 2 automjete prodhim i vitit 2019, në Gjykatën e Posaçme, 2 automjete prodhim i vitit 2019, në Gjykatën e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë u transferua një automjet, prodhim i vitit 2015 dhe në Gjykatën Administrative të Apelit u transferua një automjet prodhim i vitit 2006.

Ndërsa gjatë vitit 2023, kanë paraqitur kërkesa jashtë periudhës së hartimit të dokumentit të PBA-së, Gjykata Administrative e Apelit si dhe Gjykata e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë si dhe gjatë përgatitjes së PBA 2024 – 2026, kanë paraqitur kërkesa për automjete Gjykata e Lartë (për 5 automjete) dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë (për 3 automjete).

Struktura përgjegjëse pranë KLGJ-së (Drejtoria e Investimeve) për administrimin e aktiveve në KLGJ, bëri një analizë të gjendjes së mjeteve të transportit në gjykata dhe kërkesave të sipërcituara të ardhura nga gjykatat gjatë periudhës së përgatitjes së PBA-së dhe jashtë saj.

Bazuar në këtë analizë, edhe në gjendjen e përgjithshme teknike të këtyre mjeteve, vlerësoi shpërndarjen e 10 automjeteve të blera për plotësimin e nevojave të institucionit të KLGJ-së dhe automjetet që disponohen pranë KLGJ, që janë të gjitha në gjendje shumë të mirë teknike (prodhim i vitit 2019), të transferohen sipas nevojave dhe kërkesave të paraqitura nga gjykatat.

Për sa më sipër, bazuar në legjislacionin për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik, Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit, i propozon seancës plenare të Këshillit, shqyrtimin dhe miratimin e rishpërndarjes së automjeteve, në sistemin gjyqësor, sipas pasqyrës së mëposhtme (10 makina pranë KLGJ-së, 4 makina Hyundai Elantra Gjykatës së Lartë, 3 makina Hyundai Elantra Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë, 1 Hyundai Elantra Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, 1 Ford Explorer Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe automjeti Volkswagen Passat Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Dibër).

Duke u falënderuar, në pritje të ndonjë pyetjeje të mundshme.

Naureda Llagami: Faleminderit!

Ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votimin e projekt-aktit.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Nuk dëgjohet vota.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e rishpërndarjes (transferimin) së disa automjeteve (autovetura), në sistemin gjyqësor, sipas pasqyrës bashkëlidhur dhe pjesë e këtij vendimi.

2. Me zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 3 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2023)

Pika 4 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për konfirmimin si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtares {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

- 1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
- 2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashinë.*
- 3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
- 4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
- 5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
- 6. Staf nga administrata e KLGJ-së.*
- 7. Vladimir Karaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për konfirmimin si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtares {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me konfirmimin si ndihmësmagjistrat në Gjykatën e Lartë të gjyqtares {...} dhe zgjatjen e mandatit të komandimit me 1 (një) vit. Për më shumë detaje, fjalën e ka zoti Toro.

Alban Toro: Faleminderit!

Në Këshillin e Lartë Gjyqësor është depozituar shkresa nr. {...} prot., datë 18.07.2023, e Gjykatës së Lartë e cila ka kërkuar konfirmimin për një periudhë një vjeçare të ndihmësmagjistrates {...}, si e komanduar në Gjykatën e Lartë.

Në këtë shkresë, theksohet se në kushtet që aktualisht rezulton që Gjykata e Lartë ka vetëm 10 ndihmësmagjistratë të komanduar, ndërkohë që në referim të nenit 34, pika 4 të ligjit nr. 98/2016, më shumë se gjysma e numrit të përgjithshëm të këshilltarëve ligjorë të njësisë së Shërbimit Ligjor pranë Gjykatës së Lartë duhet të përbëhet nga ndihmësmagjistratë të komanduar, sipas procedurave të përcaktuara në ligjin “Për statusin e

gjqqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, titullari në detyrë i Gjykatës së Lartë vlerëson të nevojshme që Këshilli i Lartë Gjyqësor të vendosë konfirmimin e znj. {...} si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë, duke përsëritur komandimin e saj për një periudhë 1 (një) vjeçare.

Në analizë të kërkesës së paraqitur nga Gjykata e Lartë, relatori u mbështet në kushtet dhe kriteret për këtë figurë të posaçme të komandimit të parashikuara në nenin 56 të ligjit nr. 96/2016, ku parashikohet se:

“1 – Magjistrati mund të komandohet në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese dhe Zyrën e Prokurorisë së Përgjithshme me mandat pesëvjeçar, me të drejtë ripërsëritje, me kërkesë të institucionit ku komandohet magjistrati.

2 – Kryetari i Gjykatës Kushtetuese ose i Gjykatës së Lartë, tre muaj përpara mbarimit të afatit të mandatit të parë të komandimit të një ndihmësmagjistrati, mund t’i paraqesë Këshillit kërkesë me shkrim për konfirmimin e ndihmësmagjistratit si i komanduar në Gjykatën Kushtetuese ose Gjykatën e Lartë. [...]”.

Nga aktet e administruara në dosjen personale të gjyqtares, përcjellë nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore pranë Këshillit, rezulton se znj. {...} ka përfunduar studimet në degën Drejtësi, titulli Jurist, pranë Universitetit të Tiranës më datë 20.07.2012, ka përfunduar ciklin e dytë të studimeve Master i Shkencave në “E drejtë civile” pranë Universitetit të Tiranës në vitin 2014, dhe ka përfunduar Shkollën e Magjistraturës në vitin 2019. Me vendim nr. 8, datë 09.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor emërohet gjyqtare. Me vendim nr. 48, datë 29.01.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor caktohet në pozicion pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë. Me vendim nr. 434, datë 14.10.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, komandohet në pozicionin e "ndihmësmagjistratit", në Njësinë e Shërbimit Ligjor, pranë Gjykatës së Lartë me një afat 3–vjeçar i cili ka filluar më datë 20.10.2020, ku dhe aktualisht ushtron funksionin. Vjetërsia në ushtrimin e funksionit të magjistratit është 3 (tre) vite. Znj. {...} nuk ka masa disiplinore në fuqi.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 343, datë 14.10.2020, ka vendosur komandimin e gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, {...}, si ndihmësmagjistrate pranë Gjykatës së Lartë për një periudhë 3-vjeçare. Komandimi i kësaj gjyqtare është bërë bazuar në nenet 53, 54, 56 në pikën 4 neni 160 të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit periudha prej 3 vitesh ishte periudha maksimale e komandimit.

Si e tillë, kjo periudhë komandimi pranë Gjykatës së Lartë përfundon më datë 20.10.2023.

Figura e ndihmës magjistratit në njësinë e shërbimit ligjor të Gjykatës së Lartë, risi e nenit 34 të ligjit nr. 98/2016, është krijuar me qëllimin ligjor për të ushtruar veprimtari këshilluese dhe ndihmëse në procesin vendimmarrës të Gjykatës së Lartë duke përfshirë: a) analizimin e praktikës gjyqësore përkatëse mbi interpretimin e dispozitave të zbatueshme për çështjet në gjykim; b) analizimin e çështjes dhe përmbledhjen e procedurës; c) kryerjen e detyrave të tjera për përpunimin e çështjes siç kërkohet nga gjyqtar. Dallimi kryesor i kategorisë së ndihmësmagjistratëve si magjistratë të komanduar në krahasim me të tjerët qëndron pikërisht tek natyra e shërbimit ligjor që ai ka në përshkrimin ligjor të punës, pasi në dallim nga të tjerët ai është një figurë pothuajse gjyqësore dhe ndihmon gjithashtu edhe në shkëmbimin e përvojave më të mira reciproke në ekspertimin e ligjit. Natyrisht që komandimi ka si komponentë kohëzgjatjen e cila përbëhet nga afati mandati të parë komandues dhe kohëzgjatja/përsëritja e një mandati të dytë komandues. Komandimi i magjistratëve si karakteristikë themelore, pavarësisht nënkategorive të magjistratëve të komanduar apo të llojit të komandimit, ka faktin që lëvizja e autorizuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor është gjithnjë e përkohshme dhe për shkak të parashikimit të pikës 6 te nenit 53 të Ligjit për Statusin periudha e komandimit të magjistratit nuk mund të jetë më shumë se pesë vjet, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në ligj. Në lidhje me Gjykatën e Lartë, ligji ka parashikuar përsëritjen e saj me një kohëzgjatje maksimale 10-vjeçare. Në përfundim në rastin e miratimit të kërkesës për përsëritjen e komandimit do të duhet të respektohet afati i përgjithshëm i lejimit të komandimit, magjistrati të jetë vlerësuar “shumë mirë” në pozicionin e përkohshëm që ka pasur dhe të ketë një interes publik për konfirmimin e vijimit të detyrës së ndihmësmagjistratit pranë njësisë ligjore.

Për rrjedhim relatori në mbështetje të dispozitës së sipërcituar kërkoi, analizoi dhe administroi aktet të cilat përbëjnë kusht dhe janë të nevojshëm për të vlerësuar pranueshmërinë e kërkesës.

1. Kërkesën e Gjykatës së Lartë ku pasqyrohet kërkimi për ripërtëritjen e komandimit të ndihmësmagjistrates;

2. Pëlqimin e magjistrates;

3. Të ketë një interes publik për konfirmimin si ndihmësmagjistrate;

4. Vlerësimi etiko-profesional.

Në referim të nenit 56, pika 2 të ligjit nr. 96/2016, zëvendëskrytari i Gjykatës së Lartë, 3 muaj para mbarimit të mandatit të parë, ka paraqitur pranë Këshillit kërkesë me shkrim për konfirmimin e ndihmësmagjistrates znj. {...}, si e komanduar në Gjykatën e Lartë.

Gjithashtu rezulton që znj. {...}, më datë 18.07.2023, ka dhënë pëlqimin për t'u konfirmuar si ndihmësmagjistrate, duke kërkuar përsëritjen e komandimit me një vit. Sipas vlerësimit të gjyqtares, eksperiencia e deritanishme pranë Gjykatës së Lartë, ka qenë e tillë që ka lejuar të kontribuojë në mbarëvajtjen e punës së autoritetit më të lartë gjyqësor dhe njëkohësisht e ka zhvilluar profesionalisht.

Në kuadër të trajtimit të kërkesës së paraqitur për konfirmimin e komandimit të znj. {...}, Komisioni i Zhvillimit të Karrierës me shkresën nr. 4178/2 prot., datë 20.07.2023 i kërkoi një informacion Gjykatës së Lartë lidhur me numrin e përgjithshëm të praktikave gjyqësore ngarkuar magjistrates gjatë periudhës së komandimit në kuadër të ofrimit të shërbimit të këshilltarit ligjor dhe numrin e përgjithshëm të relacioneve e të analizave praktike të përgatitura nga ana e saj si dhe kopjen e pëlqimit të depozituar nga magjistratja për ripërsëritjen e komandimit, konform nenit 56 paragrafi i dytë i ligjit nr.96/2016.

Në përgjigjen e ardhur nga Gjykata e Lartë, me shkresën nr.{...} prot., datë 25.07.2023, rezultoi se znj. {...} ka trajtuar një numër prej 1005 praktika gjyqësorë dhe relacione të ngarkuara magjistrates gjatë periudhës së komandimit 20.10.2020-24.07.2023 në kuadër të ofrimit të shërbimit si këshilltare ligjore. Gjykata e Lartë në përgjigje është referua se znj. {...} ka ushtruar funksionin e ndihmësmagjistrates duke përgatitur relacione pranë Kolegjit Administrativ për periudhën 2020-2023 si dhe pranë Kolegjit Civil për periudhën 2020 – 2021.

Në kushtet kur për përsëritjen e komandimit, në nenin 56, pika 2 të ligjit nr. 96/2016, përcaktohet se:

“ ..omissis.. 2. Kryetari i Gjykatës së Lartë, tre muaj përpara mbarimit të afatit të mandatit të parë të komandimit të një ndihmësmagjistrati, mund t'i paraqesë Këshillit kërkesë me shkrim për konfirmimin e ndihmësmagjistratit si i komanduar në Gjykatën

Kushtetuese ose Gjykatën e Lartë. Këshilli konfirmon ndihmësmagjistratin nëse është vlerësuar të paktën “shumë mirë” në vlerësimin etik dhe profesional, si dhe nëse ndihmësmagjistrati ka dhënë pëlqimin për konfirmim.”, nga ana e relatorit, më datë 19 korrik 2023 është investuar Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale në Këshillin e Lartë Gjyqësor për vlerësimin etik dhe profesional të znj. {...}, pasi kriteri ligjore për pranueshmërinë e kërkesës përcakton minimumin, nivelin “shumë mirë” të saj.

Natyrisht ju jeni njohur me përgjigjen e natyrës së transparencës ekzibicioniste të komisionit përkatës. Gjithsesi, për shkak se transparenca përbën thelbin e punës së KZHK-së, jam i detyruar përsëri ta ripërsëris përgjigjen e komisionit përkatës i cili në përfundim ka arritur në konkluzionin që nuk mund të bëhet vlerësimi përkatës për magjistraten në fjalë. Konkretisht:

“Me shkresën bashkëngjitur emalit që po ju dërgohet, nga z. Toro kërkohet prej komisionit fillimi i procedurave të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës së komanduar si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë znj. {...}. Kjo kërkesë bazohet në nenin 56, pika 2 të Ligjit për Statusin. Sjell në vëmendjen tuaj se znj. {...}, në vitin 2023, gjatë kohëzgjatjes së komandimit të saj në Gjykatën e Lartë, ka aplikuar dy herë në procedurat e lëvizjes paralele që Këshilli ka hapur për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë si dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Me dy vendime të Këshillit, në miratimin e listave për gjyqtaret që kanë ose mund të kenë dy vlerësime, një vlerësim, apo që nuk kanë e nuk mund të kenë asnjë vlerësim, znj. {...}, është klasifikuar në listën e gjyqtarëve që nuk kanë dhe mund të kenë asnjë vlerësim. Konkretisht për këtë gjyqtare, sipas relacioneve bashkëngjitur dy vendimeve, Këshilli ka konkluduar se: "Për gjyqtaren {...}, gjyqtare e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, e emëruar në datën 09.01.2020, aktualisht e komanduar në Gjykatën e Lartë, nuk mund të ketë asnjë vlerësim, pasi kjo gjyqtare e ka plotësuar përvojën 3-vjeçare profesionale në datë 09.01.2023 dhe nuk është përfshirë në programin e vlerësimeve për vitin 2023 (ku janë përfshirë të gjithë gjyqtarët që kanë plotësuar periudhën 3-vjeçare në vitin 2022). Ky konkluzion është bazuar në rregullin e miratuar gjithashtu se: "Për gjyqtarët e emëruar nga KLGJ, për të cilët verifikimi i pasurisë e figurës është bërë prej tij, vlerësim i parë etik–profesional i mundshëm për t'u kryer,

24

do të konsiderohet ai i parashikuar në programin e vlerësimit për vitin 2023". Gjyqtarja nuk është përfshirë në programin e vlerësimeve për vitin 2023, si i tillë vlerësimi i parë etik dhe profesional për gjyqtaren do të fillojë sipas programit që Këshilli duhet të miratojë për vitin 2024. Një vlerësim i ndryshëm në këtë moment, pavarësisht se kërkohet për efekt të zgjatjes së afatit të komandimit, do të krijonte trajtim të diferencuar midis të gjithë gjyqtarëve të tjerë që kanë aplikuar për lëvizje paralele por që janë emëruar gjyqtar në të njëjtën dite me znj. {...}, sepse vlerësimi etik e profesional nuk përdoret vetëm në rast të ripërsëritjes së mandatit si i komanduar në Gjykatën e Lartë, por në përgjithësi për zhvillimin e karrierës së gjyqtarit. Nga ana tjetër, ndryshe nga rasti i mëparshëm që Këshilli ka trajtuar për znj. {...}, pasja e një vlerësimi etik-profesional në nivelin të paktën "shumë mirë" për znj. {...}, nuk përbën kusht për zgjatjen e afatit të saj të komandimit, sepse gjyqtarja me gjithë zgjatjen e kërkuar, është brenda mandatit të parë 5-vjeçar të komandimit. Znj. {...} është komanduar në Gjykatën e Lartë për një afat 3-vjeçar, ndërkohë që sipas nenit 56, pika 1 të Ligjit për Statusin, mandati i parë i komandimit të ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë është 5 vjet. Brenda këtij mandati të parë, Këshilli mund të zgjasë afatin e komandimit nga 3 deri në 5 vjet, pa qenë e nevojshme pasja e një vlerësimi etik e profesional. Pasja e vlerësimit përbën kusht vetëm në rast se do të kërkohet komandim për një mandat të dytë 5-vjeçar për ndihmësmagjistratin, sikundër ka qenë rasti i znj. {...}, e cila kishte mbaruar mandatin e parë të komandimit 5-vjeçar dhe kërkonte konfirmimin për një mandat të dytë por me kohëzgjatje 3-vjeçare. Në këtë rast ligji kërkon sipas nenit 56, pika 2 të tij, vlerësimin etik-profesional në nivelin të paktën "shumë mire". Në kushtet kur znj. {...} nuk ka plotësuar afatin 5-vjeçar të mandatit të parë të komandimit, nuk është e nevojshme dhe e detyrueshme kryerja e një vlerësimi etik dhe profesional të saj, për të zgatur afatin e komandimit edhe me një vit tjetër.

Veç sa më sipër, ju vë në dijeni se znj. {...}, sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore në KLG, është emëruar gjyqtare në datën 09.01.2020. Me vendimin nr. 48, datë 29.01.2020 ajo është caktuar në pozicion në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë. Në këtë gjykatë gjyqtarja ka punuar deri në datën 6 mars 2020, sepse është shkëputur me leje barrë lindje deri më 01.11.2020. Me vendimin 434, datë 14.10.2020 gjyqtarja është komanduar në Gjykatën e Lartë për një afat 3-vjeçar,

brenda mandatit të parë 5-vjeçar, komandim që përfundon në datën 20.10.2020. Në këto kushte gjyqtarja nuk e ka plotësuar as periudhën 3-vjeçare të komandimit, për të pasur një vlerësim të parë etik-profesional, të cilin në rastin konkret do ta marrë si e komanduar në Gjykatën e Lartë. Për sa me sipër, vlerësimi etik-profesional për gjyqtaren znj. {...} nuk mund të fillojë dhe nuk është i nevojshëm të kryhet për të zgjatur edhe me një vit afatin e komandimit, brenda mandatit 5-vjeçar të kërkuar nga neni 56, pika 1 dhe 2 i Ligjit për Statusin.”

Vlerësimi profesional dhe etik përbën një nga kushtet e vlerësuara nga Këshilli në procesin e vendimmarrjes në lidhje me pranimin e kërkesës për përsëritjen e komandimit duke siguruar jo vetëm një proces zhvillimi të karrierës së tyre të bazuar në meritokraci dhe kriteret objektive por të verifikojë edhe nëse aftësitë e magistrates kanë qenë cilësore dhe efëcente gjatë shërbimit pranë njësisë ligjore duke kontribuar në përmirësimin e lehtësimin punës së gjyqtarëve gjatë gjykimeve të zhvilluara në Gjykatën e Lartë. Marrë në konsideratë sa më lart si edhe faktin që institucioni i “Komandimit” të gjyqtarëve pranë njësisë ligjore të Gjykatës së Lartë është për t’u vlerësuar sepse i lejon gjyqtarëve jo vetëm të zgjerojnë spektrin e tyre të përvojës por i mundëson autoritetit më të lartë gjyqësor për të përfituar nga përvoja e tyre si gjyqtar, relatori i është drejtuar Gjykatës së Lartë për të administruar një vlerësim të kontributit të saj në këtë institucion.

Në kushtet kur kjo magjistrate është rekrutuar në strukturën juridiko-profesionale më të rëndësishme të Gjykatës së Lartë, vlerësimi i saj në përputhje me skemat e vlerësimit të këtij institucioni do të mund të zëvendësojë vlerësimin etiko-profesional të Këshillit, i cili për shkaqe objektive ka rezultuar se nuk mund të kryhej, duke vepruar në këtë mënyrë në përputhje me qëllimin e ligjit në përcaktimin e plotësimit të këtij kushti.

Në vijim me shkresën nr.{...} prot., datë 31.07.2023 zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë ka përcjellë “Vlerësim për punën e ndihmësmagjistrates znj. {...}, për periudhën e komandimit pranë Njësisë së Shërbimit Ligjor të Gjykatës së Lartë” nëpërmjet të cilës parashtrohet se: “Zonja {...}, nga koha e emërimit si ndihmësmagjistrate e Gjykatës së Lartë, është atashuar pranë Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, në të cilin vijon ushtrimin e detyrës. Gjatë viteve 2020-2021, znj. {...} është angazhuar edhe pranë Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Ndhmësmagjistratja ka treguar aftësi të një shkalle të larte në realizimin e ngarkesës vjetore (relacione, projektvendime). Nga fillimi i

komandimit, e deri në datë 24.07.2023 ka studiuar dhe ka përgatitur relacione për 1005 (një mijë e pesë) dosje gjyqësore. Gjatë ushtrimit të detyrës së saj, ndihmësmagjistratja ka përgatitur dokumentacionin ligjor procedural të nevojshëm për dosjet gjyqësore në ngarkim të saj. Falë njohurive të larta profesionale, përkushtimit në përmbushjen e detyrës dhe të kujdesit që ka treguar në trajtimin dhe analizimin e problemeve juridike të çështjeve gjyqësore, ndihmësmagjistratja ka qenë e aftë të evidentojë shpejt dhe në mënyrë të qartë natyrën e çështjes, duke i kushtuar vëmendje të posaçme çështjeve që parashtrojnë problematika në drejtim të zbatimit të ligjit. Në këtë mënyrë ndihmësmagjistratja ka kontribuar në evadimin efikas të çështjeve gjyqësore që i janë ngarkuar për studim dhe përpilim relacioni.

Nëpërmjet studimit dhe hulumtimit ligjor, znj. {...}, ka dhënë kontribut të qenësishëm në përgatitjen e relacionit dhe projektvendimit për vendimin njësuës nr. 00-2021-1215, vendimin (102), datë 15.07.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si dhe vendimeve të tjera për zhvillimin dhe sigurimin e praktikës gjyqësore (shih vendimet nr. 2021-142, datë 01.02.2021, vendimi nr. 2021-1259, datë 30.07.2021, vendimi nr. 2022-751, datë 25.03.2022, vendimi nr. 2022-684, datë 17.03.2022, vendimi nr. 2022-1717, datë 07.07.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë). Ndhmësmagjistratja ka treguar aftësi shumë të mira organizative në drejtim të respektimit rigoroz të veprimeve procedurale që kryhen gjatë trajtimit të dosjes gjyqësore, si dhe respektimit të afateve procedurale, me natyrë ligjore apo administrative. Ajo ka zbatuar me korrektësi urdhërimet e brendshme administrative për përgatitjen në kohë të relacionit, zbardhjen e shpejtë të vendimit gjyqësor dhe dokumentimin e shpejtë në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve të relacioneve dhe dorëzimin e rregullt dhe në kohë të dosjes në sekretarinë gjyqësore. Gjatë ushtrimit të detyrës në Gjykatën e Lartë, znj. {...} dallohet edhe për shfaqjen e sjelljeve mjaft korrekte me koleget dhe stafin administrativ. Ajo ka qenë vazhdimisht e disponueshme ndaj kërkesave të gjyqtarëve pranë Kolegjit Administrativ apo kolegeve, është komunikuese, e matur, e sjellshme dhe konstruktive në diskutimet për çështjet e punës, por edhe ato me natyrë shoqërore. Ndhmësmagjistratja ka ditur të ruajë imazhin korrekt të një zyrtari publik duke shfaqur ndjenjë të lartë të detyrës, sjellje serioze, ndershmëri dhe paanësi në ushtrimin e detyrës”.

Më tej, në kuadër edhe të analizës së moscenimit të interesit publik të cilën Këshilli i Lartë Gjyqësor, si institucion i pavarur publik, në kuptim të nenit 147/a të Kushtetutës është i detyruar të mbrojë, relatori përveç vlerësimit të kontributit të magistrates pranë Gjykatës së Lartë me anë të vendimmarrjeve të saj ka administruar edhe ngarkesën e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, ngarkesa e së cilës deri në qershor të vitit 2023 paraqitet si vijon: rreth 2325 çështje, ku ngarkesa më e pakët është diku tek 200 çështje, ndërkohë që ngarkesa më e lartë është 438 çështje gjyqësore në shqyrtim.

Nga vlerësimi i “ekuilibrit të drejtë të interesave” rezulton se vijimi i komandimit pranë Gjykatës së Lartë sjell më shumë dobishmëri dhe efektshmëri shërbimi i magistrates pranë kësaj të fundit sesa në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë. Kjo jo vetëm për faktin e rëndësisë së jashtëzakonshme të njësisë së shërbimit ligjor të Gjykatës së Lartë, të cilën ligji e konsideron si një figurë “quasi” gjyqësore, pamundësinë e sistemit për ta plotësuar edhe me shumë me gjyqtar këtë komponentë të Gjykatës së Lartë siç kërkohet nga ligji, numri i madh i jashtë zakonshëm i çështjeve të mbartura vit pas viti për zvogëlimin e të cilave kërkohet detyrimisht shërbimi i ndihmësit ligjor. Vlerësimi objektiv i dobishmërisë dhe efektshmërisë si dhe shmangia e konfliktit nëpërmjet për zgjedhjes së mjeteve të duhura për realizimin e tyre na lejon të konkludojmë se përmbushen të gjitha kriteret ligjore që mundësojnë përsëritjen e komandimit.

Përfundimisht nga ana e relatorit është përgatitur projekti përkatës në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Konfirmimin si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë gjyqtaren {...}, duke vendosur zgjatjen e mandatit të komandimit me një vit.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 20.10.2023.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Lartë si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse nuk kemi diskutime, ftoj kolegët që të votojnë mbi projekt-aktin.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Konfirmimin si ndihmësmagjistrate në Gjykatën e Lartë gjyqtaren {...}, duke vendosur zgjatjen e mandatit të komandimit me një vit.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë nga data 20.10.2023.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, Gjykatës së Lartë si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

* * *

(Pika 4 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor

29



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2023)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Pika 6 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami** (kryetare)
- 2. Ilir Rusi** (zëvendëskryetar)
- 3. Klodian Kurushi** (anëtar)
- 4. Fatmira Luli** (anëtare)

- | | |
|----------------------------|------------------|
| 5. <i>Irena Plaku</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 6. <i>Dritan Hallunaj</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 7. <i>Ridvan Hado</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 8. <i>Alban Toro</i> | <i>(anëtar)</i> |
| 9. <i>Marçela Shehu</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 10. <i>Brikena Ukperaj</i> | <i>(anëtare)</i> |
| 11. <i>Yllka Rupa</i> | <i>(anëtare)</i> |

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.*
2. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*
3. *Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.*
4. *Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.*
5. *Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).*
6. *Staf nga administrata e KLGJ-së.*
7. *Vladimir Karaj, BIRN.*

RENDI I DITËS:

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

6. Shqyrtimi i projektvendimit “Për transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë” i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë tek akti tjetër që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për renditjen e kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në

Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”. Për më shumë detaje, fjalën e ka sërish zoti Toro.

Alban Toro: Thjesht më duhet të bëj një saktësim, që pika 5 dhe pika 6 e rendit të ditës ka të njëjtin relacion dhe janë përgatitur dy projektet e veçanta, i pari që ka të bëjë me renditjen e kandidatit që në rastin konkret është kandidat i vetëm, dhe transferimi i këtij kandidati pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Po filloj me relacionin përkatës, i cili shoqëron renditjen e kandidatit në procesin e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023.

Siç jeni në dijeni, nga ana e Këshillit janë bërë përpjekje për normalizimin e gjendjes së sistemit gjyqësor shqiptar. Në rastin konkret bëhet fjalë për Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë ku kanë filluar shumë procedura të lëvizjes paralele dhe në rastin konkret janë marrë vendimet përkatëse, nr. 18, nr. 19 dhe nr. 20.

Një nga kandidatët ka qenë zoti {...}, i cili është gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, për të cilin janë bërë disa veprime procedurale, si dhe janë analizuar kriteret që mundësojnë lëvizjen paralele të kërkuar. Kështu është verifikuar përvoja profesionale minimale, mospasja e masës disiplinore në fuqi, mosqenia në situatën e papajtueshmërisë ambientale, si dhe kriteret e tjera të cilat në përfundim janë ezauruar me vendimin nr. 188, datë 25.04.2023, ku nga ana e Këshillit është vendosur kualifikimi dhe vijimi i procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për pozicionet nr. 18, nr. 19, nr. 20, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ndërkohë kemi edhe tërheqje nga kandidimi i tij, për të cilën nga ana e Këshillit është marrë gjithashtu një vendim përkatës dhe bëhet fjalë për vendimin nr. 331, datë 21.06.2023, ku është vendosur: “Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 19, datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këtë pozicion.”

Gjithashtu, paralelisht janë verifikuar edhe kriteret e tjera siç janë ato të vlerësimit etik dhe profesional. Duke qenë se kandidati përfshihej në listën e gjyqtarëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime për të ishte e nevojshme përfundimi i vlerësimeve, konkretisht: referuar pikës 5, të nenit 171, të Ligjit për Statusin: 1) vlerësimi periodik për periudhën 2017–2019; 2) fillimi i vlerësimit të përshpejtuar, për periudhën e vlerësimit janar–dhjetor 2022.

Nga ana e relatorit janë administruar vlerësimet përkatëse: a) vendimin e Këshillit nr.376 datë 17.03.2023, ku kandidati është vlerësuar për periudhën 2017-2019, në nivelin e përgjithshëm “Shkëlqyeshëm”, me një total pikësh 385 pikë. b) si dhe vendimin e Këshillit nr. 432, datë 18.07.2023, ku kandidati është vlerësuar për periudhën e vlerësimit 2022, në nivelin e përgjithshëm “Shumë mirë”, duke marrë një total pikësh 370 pikë gjithsej.

Për të dy vlerësimet, nga ana e kandidatit nuk është bërë ankim, madje në rrugë elektronike më datë 27.07.2023, është shprehur se pasi u njoh me vendimin e Këshillit, deklaroi se nuk ka ankim ndaj tyre.

Kandidati i vetëm i renditur më lart në procedurën e përzgjedhjes për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 18, datë 18.01.2023, pra z. {...}, pavarësisht kandidimit edhe për pozicione të tjera të lira për transferimin nëpërmjet lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, konstatohet që, në momentin e kandidimit, të mos ketë shprehur preferenca kandidimi sikurse përcaktohet në pikën 5, të nenit 43, të Ligjit për Statusin. Për pasojë, për këtë kandidat është e pazbatueshme preferenca e kandidimit, duke u konsideruar njësoj të preferuar për të, çdo kandidim i tij.

Kështu që, në këto kushte është përgatitur projekti i parë i cili mundëson miratimin e renditjes së kandidatit të vetëm.

Në dispozitivin e këtij drafti ju do të gjeni:

1 Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 18, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

3. Kundër vendimit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Menjëherë pas miratimit të këtij vendimi ju propozohet projektvendimi pasardhës i cili mundëson lëvizjen për në pozicionin ku ai ka kandiduar. Në dispozitivin e tij sugjerohet të miratoni:

1. Transferimin e gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë, nga ana e relatorit ju propozohet data 20.09.2023 (për shkak sepse aktualisht rezulton që zoti {...} të ketë 13 çështje civile dhe 7 çështje penale në fazën e konkluzioneve përfundimtare).

3. Një kopje e vendimit i njoftohet z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Atëherë, nëse s’kemi diskutime, kalojmë në votim.

Brikena Ukperaj: Një pyetje kam për Albanin.

Alban, relacioni u lexua për të dy projekt-aktet edhe për renditjen edhe për transferimin. Sa çështje kishte zoti {...}? Mendon që afati 1-javor do jetë i mjaftueshëm? Ose do lëmë një afat dhe pastaj të bëjmë një parashikim që gjyqtari duhet t’i mbarojë çështjet që ka në fazën e konkluzioneve përfundimtare (në civile dhe në penale). Ose ta bëjmë parashikim pikë të tretë ose pastaj të vëmë një afat më të gjatë.

34

E kuptoj që do ta konsiderojmë vend për magjistratët.

Atëherë, mund t'ia lëmë afatin 20, por të bëjmë një pikë të tretë ku t'i themi që gjyqtari ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet civile që ka në seancë gjyqësore dhe çështjet penale në fazën e konkluzioneve përfundimtare.

I lexoi Albani. Sa çështje civile ka në seancë gjyqësore? Ka 13 çështje.

Atëherë, të lëmë çështjet që ka në konkluzione përfundimtare.

Klodian Kurushi: Ne këtë e kemi diskutuar në komision bashkë të tre dhe kemi dakordësuar që çështjet që janë në konkluzione ai do t'i mbyllë tani.

Po e shikoj që kjo pikë nuk është trajtuar në relacion. Po të ishte në relacion për mua s'do ishte problem fare dhe nuk do prekej fare as dispozitivin. Por ka një problem, që nuk është në relacion.

Për të treguar pjesën e diskutimit që ne kemi bërë në komision. Është prekur edhe kjo pikë në komision, pra pjesa e çështjeve që do të mbetet për t'u trajtuar nga gjyqtari në momentin që ai do të marrë transferimin përfundimtar në Gjykatën e Tiranës. Ne kemi diskutuar me njëri-tjetrin dhe jemi dakordësuar që çështjet që janë në çështjet përfundimtare gjyqtari do t'i përfundojë. Por në pjesën e relacionit nuk ka gjetur pasqyrim ky diskutim që kemi bërë neve. Kështu që në këtë pikë, po të ishte e pasqyruar në relacion, unë do t'i qëndroja propozimit që thotë kolegu im, nuk do prekej propozimi i projektvendimit, por meqenëse ne kemi ometuar për ta vendosur këtë në relacion, ndoshta në këtë rast mund të duhej që të shtohet një pikë në dispozitivin e projektvendimit.

Marçela Shehu: Meqenëse kam përshtypjen të gjithë jemi dakord, atëherë mund të parashikojmë një pikë, pas pikës 2, ashtu siç tha Brikena dhe Klodi, që zoti {...} të përfundojë çështjet që ka në diskutim përfundimtar. Nuk shikoj asnjë lloj problemi që të jetë disponim më vete nga ana e Këshillit.

Naureda Llagami: Atëherë, pas diskutimit, kalojmë fillimisht aktin e parë që ka të bëjë me miratimin e renditjes së kandidatëve. Jemi dakord?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallur me Vendimin nr. 18, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

1. Z. {...}.

2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Pika 3 do hiqet nga teksti i këtij vendimi.

Ky vendim botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Naureda Llagami: Kalojmë tek vendimi tjetër që ka të bëjë me transferimin e gjyqtarit z. {...}. Dy kolegët kanë bërë propozimin që pas pikës 2 të shtohet... Po zoti Toro.

Alban Toro: Atëherë, natyrisht që dakordësohem me të gjithë kolegët dhe me dy propozuesit, që pas pikës së parë “1. Transferimit të gjyqtarit z. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.”, të shtohet një pikë e dytë, që: “2. Gjyqtari zoti {...} duhet të përfundojë të gjitha çështjet civile dhe penale në fazën e diskutimit përfundimtar pranë gjykatës ku ushtron detyrën.”

Naureda Llagami: Jo pas pikës së parë, por thamë pas pikës së dytë, pra do jetë pikë e tretë kjo. Po, u bë me katër pika.

Alban Toro: Dakord.

Naureda Llagami: Atëherë, e hedhim në votim bashkë me propozimin, duke qenë se u dakordësuam me këtë propozim të gjithë.

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, miratohet projekt-akti sipas propozimeve të bëra nga kolegët dhe ardhur nga relatori. Efektet juridike të këtij akti i fillojnë më datë 20 shtator 2023.

* * *

(Pikat 5 dhe 6 të rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2023)

Pika 7 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

7. Vladimir Karaj, BIRN.

RENDI I DITËS:

7. Shqyrtimi i projektvendimit “Transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Alban Toro).

Naureda Llagami: Kalojmë tek projekt-akti i radhës, që ka të bëjë me transferimin e gjyqtares znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës. Për më shumë detaje, prapë fjalën ia jap zotit Toro.

Alban Toro: Aktualisht nuk po citoj me detaje të gjithë hapat procedurale që kanë shërbyer për të shfaqur vullnetin Këshilli me vendimin nr. 467 datë 25.07.2023, gjithsesi po citoj këtë vendim i cili ka shërbyer si bazë për kryerjen e hapave të mëtejshëm procedural.

Pra me vendimin nr. 467 datë 25.07.2023 nga ana e Këshillit është vendosur miratimi i renditjes së kandidatëve në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, për pozicionin e lirë në fushën e

të drejtës civile, të shpallur me vendimin nr. 21, datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë: 1. znj. {...} dhe 2. Znj. {...}.

Ky vendim iu njoftua rregullisht të dy kandidatëve, si zonjës Kuro dhe zonjës Gjoni, si dhe zotit {...}, bazuar në pikën 10, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, gëzonin të drejtën e ankimit.

Kandidatja znj. {...}, në rrugë elektronike, më datë 26.07.2023, konfirmoi marrjen e njoftimit për vendimin.

Kandidatja znj. {...}, në rrugë elektronike, më datë 24.07.2023, konfirmoi marrjen e njoftimit për vendimin. Po ashtu, kjo candidate, në rrugë elektronike, më datë 27.07.2023, i bëri të ditur Këshillit të Lartë Gjyqësor se nuk do të ushtronte ankim.

Gjithashtu edhe kandidati z. {...}, në rrugë elektronike, më datë 27.07.2023, konfirmoi marrjen e njoftimit për vendimin, si dhe faktin se nuk do të ushtronte ankim për vendimin.

Në këto kushte vendimi ka marrë formë të prerë dhe për rrjedhim, nga ana e relatorit është bërë projekti përkatës, në dispozitivin e të cilit ju sugjerohet të miratoni:

1. Transferimin e gjyqtarës znj. {...} në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës.

2. Efektet juridike të këtij vendimi fillojnë më datë 20.09.2023.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet znj. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Për datën 20 që ju propozohet nga relatori për të hyrë në fuqi, është marrë në konsideratë edhe fakti që gjyqtarja Kuro ka aktualisht 8 çështje në fazën përfundimtare. Besoj që duhet të jetë kohë e mjaftueshme.

Nëse duhet edhe këtu të shtojmë diçka siç në rastin analog.

Pra dakordësohemi që pas pikës dy të shtohet një pikë e tretë e cila konsiston që, gjyqtarja {...} duhet të përfundojë të gjithë çështjet në fazën e diskutimeve përfundimtare pranë gjykatës ku ushtron funksionin.

Naureda Llagami: Kemi ndonjë diskutim?

Nëse jo, kalojmë në votim bashkë me propozimin që bëri vetë relatori?

Illir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet projekt-akti sipas propozimit të ardhur nga relatori dhe efektet juridike do i fillojnë më datën 20 shtator 2023.

* * *

(Pika 7 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2023)

Pika 8 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017–2019, relatores znj. Irena Plaku.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Ilir Rusi*** (zëvendëskryetar)
3. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
4. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
5. ***Irena Plaku*** (anëtare)
6. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
7. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
8. ***Alban Toro*** (anëtar)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
11. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jasthtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

7. Vladimir Karaj, BIRN.

RENDI I DITËS:

8. Shqyrtimi i projektvendimit për vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017–2019, relatore znj. Irena Plaku.

Naureda Llagami: Kemi çështjen e radhës që ka të bëjë me vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarit {...}, për periudhën 2017–2019. Zoti {...}, pasi është vënë në dijeni me projektraportin ka kërkuar që të jetë prezent në këtë seancë, për të dhënë sqarimet e veta lidhur me çështjet që ai kërkon që të informojë Këshillin.

Ftojme zotin {...}.

(Hyn në sallën e mbledhjes gjyqtari z. {...}.)

Naureda Llagami: Z. {...}, juve keni kërkuar që të jeni prezent në seancën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku do merret në shqyrtim projektraporti i vlerësimit tuaj profesional për periudhën 2017–2019.

Lidhur me procedurën që ndjek Këshilli, fillimisht fjala i jepet relatorit të projektraportit, që në rastin konkret është znj. Plaku. Më pas do ju jepet fjala juve, e cila do të konsistojë shkurtimisht vetëm për çështjet me të cilat ju nuk jeni dakord me relatorin dhe pasi ju t'i prezantoni Këshillit ato, pavarësisht se Këshilli është vënë në dijeni, ju do largoheni për t'i dhënë mundësi Këshillit që të marri vendim mbi

43

projektraportin tuaj. Kështu që pa humbur kohë unë do të ftoja relatore për të prezantuar shkurtimisht projektraportin.

Irena Plaku: Faleminderit!

Po paraqes në mënyrë të përmbledhur projektraportin e vlerësimit të gjyqtarit {...} për periudhën e vlerësimit 2017–2019. Në kushtet kur ky projektraport është njohur nga të gjithë anëtarët, por edhe nga gjyqtari i cili ndër të tjera ka paraqitur kundërshtimet lidhur me të. Procedura e vlerësimit të gjyqtarit {...} ka filluar me Vendimin nr. 371, datë 13.09.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, ku jam caktuar unë si relatore dhe nëpunëse përgjegjëse për vlerësimin Esmerilda Habili.

Janë zhvilluar të gjitha procedurat për zhvillimin e shortit, janë administruar dosjet edhe nga organet e tjera në funksion të vlerësimit.

Po kaloj shkurtimisht tek vlerësimi i katër kritereve për gjyqtarin.

Njohuritë ligjore - 1.A.a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave. Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues rezulton se referuar objektit të mosmarrëveshjes dhe natyrës së çështjes (civile themeli, familjare, kërkesë civile, gjykim penal themeli ose kërkesë e seancës paraprake) apo llojit të gjykimit, gjyqtari përgjithësisht i kushton rëndësi përshkrimit dhe analizës së fakteve të çështjes, si të atyre me natyrë procedurale, ashtu edhe të fakteve që lidhen me themelin, duke i parashtruar ato respektivisht në pjesën e parë dhe të dytë të arsyetimit të vendimit.

Paraqitja e rrethanave procedurale, në disa nga vendimet penale apo civile përshkruhen dhe po ashtu analizohen në një nënndarje që përbën pjesën hyrëse të arsyetimit, të titulluar “procedura” ose “aspekte procedurale” në të cilën parashtrohet, përveç vlerësimit të gjykatës në lidhje me juridiksionin gjyqësor, kompetencën lëndore dhe tokësore, aspektet procedurale të caktimit të seancës, njoftimit dhe pjesëmarrjes së palëve në seancë, sipas parashikimeve të K.Pr.Penale/Civile, si dhe të drejtave procedurale të tyre, për të vijuar me pas, sipas rastit, me ecurinë procedurale të çështjes. Ndërsa në disa vendime, megjithëse nuk ka një nënndarje të titulluar, gjyqtari fillon arsyetimin e vendimit me marrjen në shqyrtim të rrethanave procedurale të tij, konkretisht me vlerësimin në lidhje me juridiksionin, kompetencën.

Në vendimet gjyqësore ku janë marrë në shqyrtim rrethanat procedurale, rrethana të cilat lidhen me shqyrtimin e kërkesave të palëve apo çështjeve të ngritura kryesisht për vlerësim nga gjykata, përshkrimi i fakteve me natyrë procedurale, shoqërohet me vlerësimin dhe analizën ligjore.

Menjëherë pas paraqitjes dhe vlerësimit në lidhje me rrethanat konkrete, gjyqtari parashtron faktet e çështjes objekt gjykimi, në një nënndarje të titulluar “Rrethanat e çështjes” apo “rrethanat e çështjes / pretendimet e palëve” si në çështjet penale, ashtu edhe në çështjet civile, duke i parashtruar ato përgjithësisht në mënyrë të qartë, në një rend logjik dhe kronologjik, duke integruar përgjithësisht në përmbajte të faktit, provat përkatëse të analizuara në raport me njëra tjetrën. Përgjithësisht faktet e çështjes janë përshkruar në mënyrë koncize apo të detajuar (në varësi të kompleksitetit të çështjes), duke u shoqëruar në disa raste me evidentimin, referimin dhe analizën e provave të administruara në gjykim, për të mbështetur konkluzionet lidhur me provueshmërinë e fakteve thelbësore të çështjes, sidomos në çështjet penale të themelit, ndërsa në çështjet kërkesa penale, gjyqtari pas pasqyrimin në mënyrë të përmbledhur të fakteve, liston provat që kanë shërbyer për të provuar faktet, pa arsyetuar faktet konkrete me të cilën provohen rrethanat. Ndërsa në çështjet familjare, konstatohet se gjyqtari paraqet në mënyrë tepër të përmbledhur rrethanat e faktit, në nënndarjen e saj, por shikohet më pas që një pjesë e tyre, megjithëse nuk janë pasqyruar tek rrethanat e çështjes, përshkruhen dhe analizohen tek nënndarja “vlerësimi i gjykatës”.

- Lidhur me identifikimin e natyrës së çështjes.

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i fakteve të çështjes, gjyqtari përgjithësisht përcakton natyrën e marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, familjare apo penale. Thuajse në të gjitha vendimet civile burim vlerësimi, gjyqtari identifikon dhe përcakton qartë natyrën e çështjes objekt shqyrtimi, menjëherë pas paraqitjes së rrethanave procedurale dhe analizës së faktit. Në çështjet penale, natyra e çështjes rezulton e qartë nga objekti i çështjes dhe identifikohet në pjesën e parë të arsyetimit të vendimit, referuar specifikave të çështjeve konkrete, siç janë rastet e çështjeve të seancës paraprahe, në të cilat objekti i shqyrtimit rezulton të përcaktohet që në pjesën hyrëse të arsyetimit, duke orientuar edhe natyrën e procedimit të zhvilluar, si dhe faktet që do të

jenë objekt vlerësimi në vijim të arsytimit. Ndërsa në disa vendime penale, nga gjyqtari nuk është përcaktuar objekti i kërkesës (siç janë çështjet me objekt, dërgim çështje në gjykim apo pushim të çështjes), të cilat kuptohen nga arsytimi i gjyqtarit tek pjesa arsyetuese. Po ashtu në çështjet penale, identifikimi i natyrës së çështjes i shërben orientimit të arsytimit të vendimit.

Përcaktimi i saktë natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale, por gjithashtu lidhet me identifikimin e ligjit të zbatueshëm. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari përgjithësisht identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar përgjithësisht kujdes në moscitimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Por në disa vendime, konstatohet se gjyqtari ka cituar dispozita ligjore, të cilat nuk referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete dhe janë cituar vendimet për të cilat gjyqtari më pas ka paraqitur dhe kundërshtime.

Në të gjitha vendimet penale të themelit, tek nënndarja e titulluar “Lidhur me caktimin e llojit dhe masës së dënimit”, gjyqtari citon dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal në lidhje llojin e dënimit me burgim dhe marzhet e tyre, si dhe dënimin me gjobë dhe masën, marzhet e saj, në lidhje me përcaktimin e rrezikshmërisë së autorit kur vepra kryhet në gjendje të dehur, duke cituar nenin 18 të Kodit Penal, megjithëse këto të fundin nuk referojnë në zgjidhjen e çështjes konkrete. Përkundrazi në një rast, megjithëse kjo është cituar tek rrethanat, në fakt vepra penale në gjendje të dehur i përket cilësimit të veprës penale. Gjithashtu janë cituar disa dispozita në rastin e kryerjes së veprës penale parashikuar nga neni 130/a, disa vepra të tjera penale për caktimin e llojit të dënimit që nuk kanë lidhje me rastin konkret. Konkretisht neni 79 i Kodit Penal “vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare”, neni 321/2 megjithëse nuk ishte objekt i shqyrtimit.

Sa i përket dispozitave procedurale në projektraport janë cituar të gjitha dispozitat të cilat janë cituar nga ana e gjyqtarit si dhe shkaqet të cilat janë cituar, si ligjet materiale, dispozitat procedurale, janë të detajuara si në raportin analitik ashtu edhe në projektraport.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi mbi mesatare për paraqitjen dhe analizën e plotë të fakteve, si atyre

me natyrë procedurale, në të cilat jep një panoramë të qartë të ecurisë së çështjes dhe veprimeve të kryera, së bashku me analizën ligjore në rastet kur elementët procedurale lidhen ne trajtimin e kërkesave të palëve apo elementë procedurale të vlerësuar kryesisht nga gjykata, ashtu edhe të fakteve thelbësorë të çështjes të cilat përgjithësisht paraqiten në mënyrë të përmbledhur, duke i integruar në disa raste dhe provat e administruara në gjykim dhe faktin e ekstraktuar si pasojë e analizës dhe vlerësimit. Po ashtu rezulton se gjyqtari ka aftësi të mira në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim në zgjidhjen e çështjes, citimin dhe analizën e tyre në mënyrë të veçantë dhe në disa raste të integruar me njëra tjetrën, në funksion të përcaktimit të natyrës së mosmarrëveshjes në shqyrtim, e cila shërben si bazë për orientimin dhe analizës së çështjeve.

Pas analizës së të dhënave vlerësoj se aftësia e gjyqtarit lidhur me këtë tregues është mbi mesatare duke e pikëzuar me 20 pikë.

1.A.b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (procedurale dhe materiale – civile apo penale) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përgjithësisht bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi dhe duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore përmenden ose citohen duke u shoqëruar përgjithësisht me interpretimin e tyre abstrakt dhe aplikimin mbi faktet e çështjes, si në ato me natyrë procedurale ashtu edhe në ato që kanë lidhje me themelin e çështjes. Gjyqtari, në disa vendime burim vlerësimit, sidomos tek vendimet e zgjedhura prej tij, citimin ose referimin në dispozita e shoqëron me interpretimin të tyre në mënyrë të abstrakte, para aplikimit mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur. Por nuk i kushton të njëjtën rëndësi arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, të cilat jo gjithmonë shoqërohen me interpretim të ligjit konkret, apo me interpretimin e normave në funksion të rrethanave të çështjet sidomos tek shqyrtimi i kërkesave penale me objekt – dërgim çështjesh në gjykim apo pushim gjykimi, të cilat paraqiten në mënyrë tepër të përmbledhur, pa cituar dhe analizuar faktet konkrete si dhe aktet provuese, të cilat përgjithësisht vetëm listohen. Një interpretim i tillë konstatohet edhe tek çështjet familjare me objekt zgjidhje martesë, ku gjyqtari zgjatet në interpretimin abstrakt të ligjit, apo të natyrës së marrëdhënies së

posaçme të martesës dhe të pasojave të zgjidhjes së saj, e cila zë dhe pjesën më të madhe të vendimit, duke u ndalur shkurtimisht në interpretimin e ligjit në raport me rrethanat e çështjes.

Më pas janë cituar dispozitat të cilat ka interpretuar gjyqtari në vendimet civile dhe janë pasqyruar edhe në vendimet penale. Dispozitat procedurale të cilat janë cituar gjithashtu konstatohet se gjyqtari ka identifikuar dhe përdor gjerësisht jurisprudencën relevante të Gjykatës së Lartë, kolegji civil dhe penal, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ–së në mbështetje të argumenteve të saj në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e ligjit. Konkretisht referohen vendimet unifikuese 19/2007, vendimi unifikues nr. 1/2011, nr. 5/2011 të Gjykatës së Lartë, referon vendimin nr. 73/2002 lidhur me legjitimitimin në ankimin ndaj veprimeve përbarimore, vendimin nr. 76 të Gjykatës së Lartë në lidhje me padinë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, vendimin nr. 344 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë në lidhje me vlerësimin e kërtimeve për shtimin dhe pakësimin e detyrimit për ushqim, vendimin nr. 4/2012 të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me gjykimin e shkurtuar dhe vendimin nr. 47/2012 në lidhje me funksionet e dënimit penal, etj.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, nga tërësia e vendimeve burim vlerësimi, rezulton kujdesi i gjyqtarit që gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes të referohen dhe zbatohen parimet e përgjithshme të së drejtës, gjë që realizohet duke i përmendur ato shprehimisht apo të nxjerra nga konteksti i arsytimit të vendimit. Gjyqtari njeh, referon dhe zbaton parimet materiale dhe procedurale gjatë gjykimit, siç janë:

- Parimi i kontradiktoritetit;
- Parimi i mirëbesimit dhe të barazisë së ligjit;
- Parimin e autonomisë së vullnetit;
- Parimin e gjësë së gjykuar;
- Parimin e mosdënimit pa ligj, parimin e ligjshmërisë, etj.

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi mbi mesatare në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjet civile dhe penale. Konstatohet se gjyqtari ka aftësi të mira të interpretimit të dispozitave të ligjit material

dhe procedural, duke bërë si interpretim abstrakt të normave, duke i integruar dhe me provat e marra. Por nuk konstatohet e njëjta aftësi e gjyqtarit në interpretimin e ligjit në raport me provat e marra në shqyrtim si në çështjet penale dhe civile. Në disa vendime burim vlerësimi, interpretimi i ligjit nuk është bërë referuar rrethanave dhe fakteve të provuara. Evidentohet se gjyqtari ka identifikuar dhe zbatuar praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese, GJEDNJ si dhe ka treguar kujdes për të referuar dhe zbatuar parimet e së drejtës, si në aspektin procedural, ashtu edhe atë thelbësor, parime të cilat integrohen në arsyetim dhe mbështesin argumentet e tij lidhur me mënyrën e interpretimit dhe zbatimit të ligjit, në funksion të konkluzioneve mbi zgjidhjen e çështjes.

Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues duhet të vlerësohet “mbi mesatare”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

Arsyetimi ligjor, 1.B.a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se gjuha e përdorur nga gjyqtari gjatë gjykimit, në aktet procedurale të dosjeve të analizuara, në komunikimin shkresor me të tretët dhe në vendimet gjyqësore, është e qartë, e drejtpërdrejtë dhe e kuptueshme.

Në përdorimin e instituteve të së drejtës apo parimeve të përgjithshme të së drejtës procedurale dhe materiale, evidentohet përdorimi i termave/shprehjeve në gjuhën latine, përgjithësisht të etiketuara (në thonjëza), duke u shoqëruar me dhënien e kuptimit të termit/shprehjes përkatëse, pa krijuar konfuzion. Në referimin e fjalëve me karakter teknik, kryesisht në referimin e konkluzioneve të akteve të ekspertimit apo në kuadër të referimit të ligjeve të posaçme, përdorimi i termave teknike është i kufizuar, i shoqëruar me shpjegimin e tij.

Nuk evidentohet në asnjë rast përdorimi i fjalëve apo shprehjeve që mund cenojnë integritetin e personit, si dhe evidentohet kujdes për shmangien absolute të përdorimit të fjalëve të cilat mund të krijojnë kontekst fytes apo denigrues.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i rregullave gramatikore, të sintaksës në ndërtimin e fjalive, duke i dhënë qartësi përshkrimit të rrethanave procedurale dhe fakteve të çështjes, apo shprehjes së mendimit juridik. Në të gjitha vendimet gjyqësore rezulton përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe

ç). Përdor shenjat e pikësimit, thonjëzat dhe simbole të tjera, sipas përkatësisë. Fjalitë ndërtohen drejt dhe janë të organizuara në rrjedhë logjike të njëra-tjetrës, dhe paragrafët apo nëndarjet e arsytimit të vendimit gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi.

Në konkluzion, referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari i kushton rëndësi të posaçme arsytimit të vendimeve në drejtim të qartësisë dhe kuptueshmërisë për lexuesin. E njëjta rëndësi evidentohet edhe në drejtim të koncizitetit të pjesës përshkuese, në çdo nëndarje, duke i dhënë peshën e nevojshme në arsyetim çdo pjese të vendimit, sipas përmbajtjes.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit për këtë tregues është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit.

Gjyqtari ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar nga pikëpamja formale, të cilës i përmbahet në prezantimin e fakteve me natyrë procedurale, megjithëse jo në të gjitha vendimet, apo të themelit të çështjes, identifikimit të ligjit të zbatueshëm, argumentimin ligjor dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Këto të fundit vijnë gjithnjë si mbyllje e procesit të arsytimit ligjor dhe argumentimit logjik. Gjyqtari ndjek përgjithësisht një metodologji të njëjtë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke ndarë pjesën përshkuese-arsyetuese në nëndarje, përgjithësisht të identifikuara me tituj, në funksion të orientimit mbi qëllimin e secilës pjesë dhe në të gjitha rastet, këto pjesë janë ndarë në paragrafë, të cilat e lehtësojnë shumë të kuptuarit e vendimit duke mundësuar referimin në paragrafët e mësipërm. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse përgjithësisht gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit të çështjes, trupi gjykues dhe sekretaria gjyqësore, data e shqyrtimit, palët, përfaqësuesit e tyre, prezenca ose mungesa e tyre në seancë, objekti i shqyrtimit, baza ligjore si dhe kërkimet përfundimtare të palëve, të paraqitura në mënyrë të përmbledhur. Por në një vendim mungon pasqyrimi i plotë i palëve pjesëmarrëse në proces, të cilët janë tepër të domosdoshëm të paraqiten, pasi nga paraqitja e tyre lidhet më pas njoftimi nga

sekretaria i vendimit të gjykatës dhe ushtrimi i të drejtës së ankimit për raste e parashikuara në ligj. Konkretisht, është përmendur edhe vendimi penal, i dhënë pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2017, datë 30.03.2017 “Për disa ndryshime në Kodit të Procedurës Penale”, mungon pasqyrimi i të dëmtuarës nga vepra penal. Ndërsa në tre vendime penale, seancë paraprake dhe me objekt pushim gjykimi mungon pasqyrimi i objektit të kërkimit, dhe të krijohet përshtypja se është çështje penale themeli. Gjithashtu, në vendimet me objekt lëshim urdhër ekzekutimi, të dhëna pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve të bëra në Kodin e Procedurës Civile, me ligjin nr.114/2016, mungon pasqyrimi i gjeneraliteteve të palës debitore, sipas përcaktimeve të bëra në nenit 511 paragrafi i 3 të KPRC. Sipas këtij neni, gjykata kur lëshon një urdhër ekzekutimi në vendimin e saj ndër të tjera duhet të përcaktojë dhe gjeneralitet e debitorit dhe kreditorit, në mënyrë që pas lëshimit të urdhrit të ekzekutimit shërbimi përmbartimor të ekzekutojë detyrimin e përcaktuar në të kundërt debitorit. Ndërsa në vendimin gjyqësor familjar me nr. 455–180, me objekt zgjidhje martesë, palët ndërgjyqëse dhe objekti i padisë janë përcaktuar jo sipas përmbajtjes së kërkesë padisë me të cilën është vënë në lëvizje gjykata, ku janë përcaktuar si paditës dhe i paditur dhe objekt zgjidhje martese e rregullimi i pasojave të saj, duke u përcaktuar si kërkues dhe objektin e zgjidhje martese dhe miratim projekt marrëveshje.

Pjesa përshkuese-arsyetuese është e ndarë në disa nënpjesë, të cilat më pas janë përshkruar që nuk janë vërejtur ndonjë gjë që mund të evidentohet.

Rrethanat e çështjes së bashku me përshkrimin dhe analizën e provave të lejuara janë më vete.

Vlerësimi i gjykatës lidhur me çështjen. Pas evidentimit dhe analizës së elementëve procedurale, fakteve të çështjes dhe referimit të ligjit të zbatueshëm, arsyetimi vijon me një nënndarje të titulluar kryesisht “Vlerësimi i gjykatës”, në të cilin, sipas kategorisë së vendimeve gjyqësore zhvillon analizën ligjore të çështjes. Kjo analizë, referuar kompleksitetit të çështjes është e organizuar në disa rasteve në nënndarje, ku merren në analizë secili nga kërkimet e objektit të padisë, apo analizën lidhur me përgjegjësinë penale për secilin të pandehur apo vepër për të cilën procedohet, në vendimet penale. Në këtë pjesë konstatohet se mendimi juridik është i ndarë në paragrafë të numërtuar, që të mundësojë një kuptim të qartë të analizës juridike. Në vendimet

penale të themelit gjyqtari e ka organizuar këtë pjesë të vendimit duke analizuar fillimisht elementët e figurës së veprës penale për secilin të pandehur për të vijuar me pas me analizën ligjore në drejtim të caktimit dhe individualizimit të dënimit.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës, data e shpalljes së vendimit dhe nënshkrimi i gjyqtarit dhe sekretares gjyqësore. Konstatohet se dispozitivi i vendimeve është i plotë dhe në të gjejnë pasqyrim: disponimi i gjykatës, disponimet lidhur me shpenzimet.

Përgjithësisht vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar nënin 310 të K.Pr.Civile, në vendimet civile dhe familjare, (ii) nenet 332/ç, 332/dh dhe 332/e dhe nenin 329/b të K.Pr.Penale.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi mbi mesatare në ndjekjen e një strukture të organizuar të vendimit, të ndarë në tituj dhe gjithmonë mendimi është ndarë në paragrafë të numërtuar. Gjyqtari ndjek përgjithësisht një strukturë sipas këtij rendi: trajtimi i aspekteve procedurale të ngritura gjatë gjykimit apo të vlerësuara kryesisht nga gjykata, parashtrimi i rrethanave të faktit, ligjin e zbatueshëm, trajtimi i çështjeve që duhet të shqyrtohen nga gjykata në lidhje me themelin, duke përfshirë analizën e pretendimeve të palëve dhe në fund të pjesës arsyetuese ose të çdo pjesë të veçantë të tij, përfundimet e arritura nga gjykata. Konstatohet që për çdo nënndarje apo njësi e vendimit të jenë vendosur titujt përkatës dhe fjali tematike, për orientimin e duhur të palëve dhe gjykatave më të larta mbi përmbajtjen e vendimit si dhe në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij duke mundësuar përgjithësisht lexim të organizuar dhe të strukturuar në rrjedhë logjike. Por nuk konstatohet e njëjta qartësi në pjesën e parë të vendimit, konkretisht me paraqitjen e saktë të palëve pjesëmarrëse në gjykim si dhe të objektit të kërkimit, pasi në disa vendime, mungon pasqyrimi i plotë i palëve pjesëmarrëse në gjykim apo pasqyrimi jo i duhur i tyre, i cili është tepër e domosdoshëm pasi lidhet drejtpërdrejtë me qartësinë e vendimit si për sekretarinë gjyqësore, e cila do të bëjë njoftimet e vendimit palëve pjesëmarrëse, e më pas me të drejtën e ankimit si dhe orientimin e gjykatave më të larta lidhur përmbajtjen e vendimit në shërbim të qartësisë dhe kuptueshmërisë së tij.

Pas analizës së të dhënave, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit në këtë tregues vlerësohet “mbi mesatare” dhe pikëzohet me 8 pikë.

1.B.c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik.

Në vendimet e analizuara, përgjithësisht rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të nevojshëm të vlerësuar nga gjyqtari në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale të gjykimit, kryesisht çështje të kompetencës lëndore; përcaktimit të barrës së provës dhe rolin e gjykatës në funksion të vlerësimit të shkakut ligjor të padisë; rolin dhe funksionin e gjyqtarit të seancës paraprake dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes në këtë fazë të procedimit; procedimit me gjykim të shkurtuar si dhe pjesëmarrjen dhe të drejtat e të dëmtuarit në gjykim, etj.

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare, pas përcaktimit të fakteve të çështjes, të cilat përgjithësisht paraqiten në mënyrë të saktë dhe koncize, zhvillohet mbi bazën e një analize juridike të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material duke bërë një analizë tërësore dhe të përmbledhur të provave të administruara, në funksion të përcaktimit të fakteve të vlerësuara si të provuara në gjykim.

Në vendimet civile burim vlerësimi gjyqtari i kushton rëndësi analizës me të zgjeruar të instituteve dhe koncepteve të caktuara të së drejtës, kur kjo rezulton e nevojshme, duke qenë më e kufizuar në analizën e këtyre instituteve dhe koncepteve në raport me rrethanat konkrete.

Në projektraport janë pasqyruar edhe analizat e dispozitave dhe analiza juridike e bërë secilës dispozitë në çështjet konkrete.

Në vendimet penale burim vlerësimi, gjyqtari paraqet dhe analizon faktet të cilat kanë rezultuar të provuara në gjykim dhe merr në analizë elementët e figurës së veprës penale për të cilën procedohet, rolin dhe përgjegjësinë penale të të pandehurit në raport me faktin penal. Çdo fakt i vlerësuar si i provuar lidhet në mënyrë të drejtpërdrejtë shpeshherë me provën/provat përkatëse, me aspektet ligjore konkrete të cilat ato mbështesin, si dhe elementin që sjell secila prej tyre në shërbim të provueshmërisë së tij. Gjyqtari integron faktin e provuar me analizën dhe interpretimin e ligjit të zbatueshëm në rastin konkret, si në drejtim të kualifikimit ligjor të faktit penal, ashtu edhe në drejtim të vlerësimit të kushteve ligjore për zgjidhjen e çështjeve me karakter procedural. Por konstatohet se argumenti logjik përgjithësisht dominohet nga analiza konkrete e koncepteve ligjore të së drejtës materiale ose procedurale, në raport me zbërthimin dhe

analizën e këtyre koncepteve ligjore në lidhje me faktet e çështjes dhe aktet provuese mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtarit, të cilat përgjithësisht vetëm përshkruhen siç kanë rezultuar pa u bërë një analizë individuale nga gjyqtari. Pra konstatohet që faktet vetëm vendosen në pjesën e analizës.

Gjyqtari ndalet në evidentimin e qartë dhe në mënyrë të natyrshme të lidhjes shkak-pasojë mes veprimeve të të pandehurit në raport me faktin penal të provuar në çështjet e themelit, faktin penal objekt akuze në çështje të seancës paraprake. Në çdo rast interpretimi dhe analiza e integruar e normave ligjore procedurale dhe materiale, në raport me faktet e provuara në gjykim, edhe pse kjo pjesë paraqitet tepër e përmbledhur në disa raste, i shërben arsytimit ligjor dhe zhvillimit të argumentimin logjik, në mbështetje të konkluzioneve të saj për zgjidhjen e çështjes.

Konstatohet se gjyqtari i kushton rëndësi identifikimit dhe analizës së koncepteve ligjore të së drejtës materiale ose procedurale në lidhje me konkluzionet e arritura për zgjidhjen e çështjes, e cila zë dhe pjesën më të madhe të vendimit, duke bërë një analizë për qëllimin dhe funksionin përkatës të dispozitave, si dhe të zërthimit të kushteve apo elementëve të nevojshëm me qëllim që dispozita përkatëse të gjejnë zbatim në rastet konkrete në shërbim të konkluzioneve të arritura për zgjidhjen e çështjes. Por nuk konstatohet e njëjta shkallë kujdesi tek të gjitha vendimet, si tek vendimet civile, familjare apo dhe kërkesat penale, në drejtim të zhvillimit të analizës ligjore dhe argumentit logjik, në raport me faktet e provuara në funksion të mbështetjes së marrëdhënies shkak-pasojë, e cila konstatohet se përgjithësisht është skematike. Në të gjitha vendimet burim vlerësimi, analiza përqendrohet kryesisht në interpretimin abstrakt të dispozitave, e cila dominon pjesën e vlerësimit të gjykatës, duke e shoqëruar edhe me praktikën e unifikuar të Gjykatës së Lartë, apo dhe të qëndrimeve të mbajtura nga Gjykata Kushtetuese, ndërsa analiza ligjore në raport me faktet e provuara, pra argumenti logjik në raport me faktet e provuara paraqitet në mënyrë të përmbledhur, duke mos integruar gjithmonë si pjesë të saj edhe provat mbi të cilat mbështetet konkluzioni i gjyqtarit për provueshmërinë e fakteve konkrete. Analiza e koncepteve ligjore të së drejtës materiale ose procedurale në lidhje me konkluzionet e arritura për zgjidhjen e çështjes, është shumë e rëndësishme, por nuk është e mjaftueshme në raste se kjo analizë nuk shoqërohet edhe me një analizën të detajuar të provave të marrë në shqyrtim, e cila

gjithashtu është një pjesë shumë e rëndësishme e arsytimit të vendimit gjyqësor në tërësi. Në dy vendime penale, konstatohet se analiza ligjore gërshetohet në mënyrë të detajuar edhe me provat e marra në shqyrtim, duke pasqyruar tërësisht përmbajtjen e secilës provë (deklarimet e personave që kanë dijeni për veprën penale), të përshkruar fillimisht tek pjesa “rrethanat e çështjes”, çka ka bërë vendimi të jetë i gjatë dhe me pjesë të përsëritura. Në vendimet gjyqësore, gjyqtari nuk duhet të jetë thjesht përshkruar i rrethanave apo i provave, por duhet të analizojë provat në raport me njëra tjetrën, duke e gërshetuar arsytimin e tij në raport ligjin që gjen zbatim.

Sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve – Arsytimi i vendimeve përgjithësisht është i qartë dhe gjithëpërfshirës, duke marrë në analizë dhe duke i dhënë përgjigje pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse, të cilat janë integruar ndonjëherë në pjesën “rrethanat e faktit” ashtu edhe në pjesën e “vlerësimit të gjykatës”, analizë e cila paraqitet në mënyrë të përmbledhur. Por nuk konstatohet që gjyqtari të identifikojë qartë dhe në mënyrë të plotë, duke i paraqitur të ndara pretendimet e palëve, por ata dalin si rezultat i analizës juridike. Në çështjet më komplekse, gjyqtari është kujdesur të pasqyrojë dhe marrë në analizë pretendimet e palëve ndërgjyqëse (duke krijuar edhe paragrafë me fjali hyrëse në lidhje me këto pretendime), si në raport me arsytimin e koncepteve ligjore dhe zberthimin e këtyre koncepteve në raport me rrethanat e provuara dhe provat përkatëse ku palët bazojnë pretendimet e tyre.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke i vlerësuar tërësinë e tyre në raport me natyrën e çështjeve, komplekse ose jo, rezulton se gjyqtari ka aftësi mbi mesatare në lidhje me këtë tregues. Konstatohet së vendimet gjyqësore burim vlerësimi, në varësit të kompleksitetit të çështjes dhe pretendimet e palëve, në pjesën analitike të tyre përmbajnë argumente të lidhura me njëri-tjetrin, duke i ndalur shkurtimisht tek evidentimi i lidhjes shkak-pasojë. Përgjithësisht gjyqtari i kushton rëndësi analizimit të pretendimeve të palëve në raport me ligjin që gjen zbatim si dhe me rrethanat konkrete të çështjes, duke i dhënë përgjigje të argumentuar si për çështjet e procedurës ashtu dhe ato për themelin e çështjes. Megjithatë, referuar burimeve të vlerësimit nuk evidentohet e njëjta shkallë kujdesi në drejtim të analizës dhe argumentit logjik, si në raport me rrethanat e faktit ashtu edhe në raport me pasqyrimin

e pretendimeve dhe analizimin e tyre, pasi elementi analitik në pjesën më të madhe të vendimit dominohet nga analiza abstrakte e dispozitave ligjore që gjejnë zbatim apo të natyrës juridike të gjykimit, të padisë apo kërkimit konkret me të cilën palët i janë drejtuar gjykatës, duke u pasuruar me qëndrimet e praktikës gjyqësore dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, dhe një pjesë me e vogël në përshkrimin dhe analiza e fakteve të çështjes, e cila në disa raste nuk analizohet por vetëm përshkruhen për të mbështetur konkluzionet e arritura nga gjyqtari. Përgjithësisht, arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve apo çështjeve të shtruara për diskutim në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigjeje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së çështjes, por nuk konstatohet e njëjta analizë tek çështjet komplekse, të cilat në fakt evidentojnë më qartë shkallën e analizës dhe argumentit logjik të gjyqtarit.

Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në këtë tregues është “mbi mesataren” dhe duhet të pikëzohet me 20 pikë. Ky konkluzion bazohet në analizën e metodologjisë së përgjithshme të punës së gjyqtarit në drejtim të këtij treguesi, duke analizuar të gjitha llojet e çështjeve të përzgjedhura, pa i dhënë peshë dhe rëndësi të veçantë asnjërës prej tyre.

Kështu, propozimi për kriterin e parë “Aftësia profesionale e gjyqtarit” është me 83 pikë, niveli i vlerësimit "Shumë mirë".

Kriteri “Aftësia organizative e gjyqtarit” – 2.A.a. Respektimi i afateve ligjore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik dhe tabelave me të dhëna statistikore për periudhën e vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka gjykuar gjithsej 736 çështje për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, të cilat i përkasin kategorisë së çështjeve “Civile të përgjithshme me palë kundërshtare”, “Civile të përgjithshme pa palë kundërshtare”, “Familjare me palë kundërshtare”, “Kërkesa penale në fazën e hetimit paraprak” dhe “Penale seancë parapake”.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 736 çështje për të cilat ligji parashikon afate gjykimi, 277 prej tyre janë shqyrtuar në tejkalim të këtij afati ndërsa 459 çështje janë shqyrtuar brenda afateve ligjore. Referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të afatit ligjor (277 çështje), me

numrin total të çështjeve të gjykuara për të cilat ligji parashikon afat gjykimi (736 çështje), gjyqtari rezulton që të ketë gjykuar 37.6 % të çështjeve jashtë afatit ligjor.

Në Formularin e Integruar gjyqtari e ka vlerësuar treguesin “Respektimi i afateve ligjore” në shkallë shumë të lartë, por nuk ka dhënë shpjegime.

Në përlllogaritjen e afateve ligjore, për të gjitha dosjet, përlllogaritja e afateve do të fillojë nga data e shortimit (pra, data kur çështja ka shkuar pranë gjyqtarit), dhe jo ajo e regjistrimit. Në të gjitha dosjet, në përlllogaritje do të zbriten: leja vjetore e muajit gusht prej 35 ditësh si dhe festat e fundvitit (praktikë që e kemi ndjekur edhe tek vlerësimet e tjera).

Kështu, referuar tabelave me të dhëna statistikore, pasi janë marrë në analizë çështjet të cilat janë rillogaritur edhe një herë data e shortit apo janë zbritur edhe afati i kryerjes së lejes vjetore, ka rezultuar, duke konsideruar shpjegimet e mësipërme, janë 131 çështje që janë konsideruar si për përfunduara brenda afatit ligjor.

Duke iu referuar tabelës me të dhëna statistikore në çështjet e analizuar më sipër rezulton se numri i çështjeve me afat ligjor nga 736 çështje.. d.m.th. në numrin e çështjeve me afat ligjor, të përfunduara tej këtij afati (277 çështje), duhet të zbriten 131 çështje, pasi referuar analizës për secilën prej tyre, rezultoi se ato duhet të konsiderohen të përfunduara brenda afatit ligjor.

Në këtë mënyrë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkalim të këtij afati, ka zbritur në 146 çështje me numrin total të çështjeve (736 çështje), rezulton të jetë 19.8 %, përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 12 pikë.

Por pasur parasysh referuar metodologjisë së pikëzimit lidhur me këtë tregues është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, etj.

Në rastin konkret, në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtari ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3–vjeçare 1681 çështje, nga të cilat 736 çështje parashikojnë afati ligjore gjykimi. Pra, 43,8% të numrit total të çështjeve kanë qenë me afat ligjor, përqindje tepër e lartë duke e ngarkuar

shumë gjyqtarin me çështje që kërkonin shpejtësi gjykimi. Gjithashtu, rezulton se nga numri i përgjithshëm i çështjeve, 933 çështje janë me palë kundërshtare.

Referuar standardit sasior në fuqi, gjyqtari duhet të përfundonte jo më pak se 200 çështje me palë kundërshtare në vit, pra 600 çështje në tre vjet. Në rastin konkret, gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtari ka përfunduar 933 çështje me palë kundërshtare, ose 311 çështje në vit nga 200 çështje që është e përcaktuar në vendimin nr. 261/2, datë 14.04.2010 të ish-KLD-së, duke e kaluar standardin sasior me 333 çështje apo me 55.5 %.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të lartë për zhvillimin e gjyqimit brenda afateve ligjore. Nëse në përlogaritjen e çështjeve të shqyrtuara jashtë afatit ligjor, përjashtohen çështjet ku afati ligjor është tejkaluar me një kohë relativisht të shkurtër (1 deri në 2 ditë) si dhe zbritet koha gjatë se cilës gjyqtari ka kryer lejen vjetore, atëherë numri i çështjeve të përfunduara jashtë afatit do të rezultonte 146 çështje dhe për pasojë, raporti i çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të afatit ligjor (146 çështje), me numrin total të çështjeve, rezulton të jetë 19.8 % të çështjeve të përfunduara tej afatit ligjor, përqindje e cila pikëzohet me 12 pikë. Por për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara në tejkallim të afatit ligjor, (ii) ngarkesën e gjyqtarit si relatore (në total për tre vite ka gjykuar 1681 çështje, nga të cilat 43.8 % apo 736 çështje janë me afat ligjore), duke gjykuar mesatarisht rreth 560 çështje në vit nga të cilat 245,3 janë me afat ligjore, faktin se ai e ka tejkaluar standardin sasior mesatare me 55.5 % dhe (iii) aspektet që lidhen me kushtet e punës, konkretisht angazhimin si anëtar i trupave gjykues, kohën që gjyqtari kalon në zhvillimin e seancave, gjyqtari për këtë tregues vlerësohet në nivelin maksimal të tij, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Pas analizës së të dhënave vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në këtë tregues është “shumë e lartë”, brenda marzhit “0 – 10 %”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

2.A.b. Plotësimi i standardeve minimale kohore.

Sipas të dhënave të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se nga 946 çështje të përfunduara gjatë periudhës së vlerësimit, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, 200 prej tyre ose 21 % janë gjykuar tej standardit minimal kohor në fuqi.

Edhe për këtë tregues referuar standardeve të krijuara janë zbritur koha e pushimeve vjetore, gjithashtu janë vlerësuar të gjitha aspektet të cilat janë vlerësuar edhe në treguesin e mësipërm. Është bërë edhe një herë përpunimi të dhënave statistikore dhe konkretisht janë zbritur nga numri i pasqyruar në raportin analitik dhe disa çështje të tjera të cilat janë konsideruar si të shqyrtuara brenda standardit minimal, pra gjithsej nga analiza e të dhënave rezulton se 61 çështje që do të llogariten të gjykuara brenda standardit minimal kohor dhe do t'i zbriten numrit prej 200 çështjesh të përlogaritura në raportin analitik, duke mbetur kështu 139 çështje.

Duke konsideruar sa më sipër, numri total i çështjeve për të cilat parashikohet standardi minimal kohor është 946 dhe numrit total të çështjeve të përfunduara jashtë standardit minimal kohor, e cila nuk është më 200, por rezulton të jetë 139 çështje, ose 14.6% e numrit total të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor. Sipas “Metodologjia e pikëzimit, niveli i vlerësimit pikëzohet me 4 (katër) pikë.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, në përcaktimin e nivelit të vlerësimit për këtë tregues, të dhënat statistikore analizohen duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Vlerësuesi mund të përcaktojë një shkallë më të lartë pikëzimi duke marrë parasysh tregues të tjerë që lidhen me produktivitetin e gjyqtarit, siç është në rastin konkret, treguesi sasior i punës së gjyqtarit, ku siç rezultoi më sipër rezulton që të jetë shumë i lartë pasi në periudhën 3–vjeçare të vlerësimit ne total 1681 çështje nga të cilat 933 çështje me palë kundërshtare.

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit (139 çështje) me numrin total të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal; (ii) faktorët që ndikojnë në kohëzgjatjen, të cilat përgjithësisht nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit dhe (iii) tejkalimin e standardit sasior të zbatueshëm në masën 55.5 %, (iv) shqyrtimi i një numri të madhe të çështjeve me afat ligjor prej 736 çështje (43.8 %) që kërkon angazhim të madh të gjyqtarit, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet në nivelin maksimal. Konkretisht propozohet pikëzimi i tij me 5 pikë për shkak se ka tejkaluar edhe standardin sasior me 55,5%.

2.A.c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje. Janë ndarë çështjet sipas kategorive (nuk po i përshkruaj për sa kohë janë përshkruar gjerësisht në raport).

Në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se për të bërë pikëzimin e këtij treguesi, të dhënat statistikore analizohen sipas situatës për të shmangur përfundimet që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Referuar metodologjisë, duke qenë se shumicën e kategorive të çështjeve (9 nga 10 kategori), koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, përveç kategorisë “Familjare pa palë kundërshtare”, ku standardi minimal kohor është tejkalluar me vetëm 4 ditë, çka vlerësohet tejkallim i papërfillshëm, gjyqtari duhet të pikëzohet në nivelin maksimal për këtë tregues.

Për sa më sipër, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtari duhet të vlerësohet me 5 pikë, duke konsideruar afatin e kohës mesatare që i dedikohet çdo çështjeje më të shkurtër ose të barabartë me standardin minimal kohor për të gjitha kategoritë e çështjeve.

2.A.ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se rendimenti i përfundimit të çështjeve, për të gjithë periudhën e vlerësimit (01.01.2017-31.12.2019) si raport midis numrit të çështjeve të përfunduara (1681 çështje) me numrin e çështjeve të caktuara (1992 çështje) brenda periudhës 3-vjeçare të vlerësimit, është 84.4 % përqindje e cila sipas Metodologjisë pikëzohet me 4 pikë, duke qenë se rezulton 81-87%.

Lidhur me këtë tregues gjyqtari ka paraqitur shpjegime.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin mesatar, ku ka thënë se: “Për vitin 2017 janë regjistruar në emrin tim 632 çështje dhe kam përfunduar 522 [...]”, dhe ka dhënë shpjegime të cilat janë pasqyruar në projektraport.

Referuar treguesit sasior, rezultoi se gjyqtari ka përfunduar në periudhën 3-vjeçare të vlerësimit në total 1681 çështje nga të cilat 933 çështje me palë kundërshtare. Referuar standardit sasior në fuqi, gjyqtari duhet të përfundonte jo më pak se 200 çështje me palë kundërshtare në vit, pra rezulton se ai e ka tejkalluar standardin me 55.5 %.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit rezulton në masën 84.4 %, por ndërkohë rezulton se (i) ai ka tejkaluar standardin sasior për çështjet e themelit të përfunduara me 55.5 %, (ii) ka përfunduar një numër të konsiderueshëm çështjesh me palë kundërshtare (933 çështje) dhe 748 çështje pa palë kundërshtare, nga të cilat 736 çështje kanë qenë me afat ligjor, vlerësohet se, në analizë logjike të të dhënave statistikore, duke marrë në konsideratë përqindjen e çështjeve të shqyrtuar tej standardit minimal sasior dhe ngarkesën totale në punë, gjyqtari duhet të vlerësohet dhe pikëzohet në dy nivele më lart se ajo që i korrespondon analizës statistikore.

Referuar sa më sipër, vlerësohet se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues duhet të pikëzohet me 8 pikë.

2.A.d. Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor.

Edhe për këtë tregues është analizuar koha mesatare e arsytimit të vendimeve.

Ka rezultuar nga 6 (gjashtë) nën kategoritë e kategorisë “kërkesa penale të hetimit paraprak”, vetëm në 3 prej tyre, koha mesatare e arsytimit e ka tejkaluar afatin procedural.

Për nënkategorinë “kërkesa me objekt shuarje mase sigurimi, koha mesatare e arsytimit është vetëm 0,6 ditë (pra disa orë) më e gjatë se afati procedural prej 48 orë.

Nga të dhënat statistikore, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit është tejkaluar në nënkategoritë e çështjeve me objekt “caktim mase sigurimi”, “verifikim i kushteve të zbatimit të masës së sigurimit” si dhe “shuarje mase sigurimi”.

Pra, gjyqtari e ka tejkaluar kohën mesatare të arsytimit vetëm në gjysmë kategorie (tre nënkategori nga gjatë gjithsej), nga 10 kategori çështjes.

Sa më sipër, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se koha mesatare e arsytimit të vendimit gjyqësor përfundimtar, është më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve, që sipas Metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 12 pikë.

Në Formularin e Integruar gjyqtari e ka vlerësuar këtë tregues në nivelin shumë të lartë, por pa dhënë shpjegime.

Sipas metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të

volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%. Duke pasur parasysh të dhënat statistikore janë cituar sa më sipër, vlerësoj se për këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale, pra me 15 pikë.

Për sa më sipër, në lidhje me treguesin “Koha mesatare...” vlerësoj se koha mesatare e tyre duhet të konsiderohet më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve, e për këtë arsye gjyqtari pikëzohet me 15 pikë për shkak se ka përballuar një ngarkesë të lartë në punë.

2.B. Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore.

2.B.a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive.

Referuar të dhënave të analizuara në Raportin Analitik, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh, duke përjashtuar ato pa palë kundërshtare, rezulton si më poshtë:

- (i) për kategorinë e çështjeve ”Penale themeli”, është 2,3 seanca gjyqësore.
- (ii) për kategorinë e çështjeve/kërkesave “Seanca paraprake”, etj, është 1,66 seanca gjyqësore.
- (iii) për kategorinë e çështjeve “Familjare me palë kundërshtare”, 2,6 seanca.
- (iv) për kategorinë e çështjeve “Civile me palë kundërshtare”, është 6,25 seanca.

Numri mesatar i seancave gjyqësore, ka dalë 3,05 seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura me short evidentohet se gjyqtari përgjithësisht kryer në mënyrë efektive veprimet për vënien në lëvizje të çështjes, ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta.

Seancat përgjithësisht janë shtyrë për shkaqe të ndryshme procedurale të tilla si: në kushtet e mosparaqitjes së gjyqtarit për fatkeqësi familjare apo për shkak të trajnimeve në Shollën e Magjistraturës; në kushtet e mosparaqitjes së prokurores për arsye familjare; etj.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, megjithëse numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, duke tejkaluar me 0.5 seanca, tejkalim i cili vlerësohet i papërfillshëm si dhe faktit se shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproduktive është i lartë, vlerësoj se gjyqtari duhet të pikëzohet në nivelin maksimal me 15 pikë.

2.B.b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor.

Referuar Raportit Analitik dhe dosjeve të përzgjedhura për vlerësim, rezulton se gjyqtari në përgjithësi ka vënë në lëvizje çështjet duke marrë vendim për kryerjen e veprimeve paraprake, për caktimin e seancës përgatitore dhe/ose gjyqësore pas caktimit të çështjes me short duke iu referuar rregullave dhe gjykimit sipas kategorive të çështjeve. Konkretisht në disa çështje civile gjykata është shprehur me vendim për caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore si dhe njoftimin e palëve. Ndërsa nga verifikimi i akteve të dosjeve burim vlerësimi, rezultoi se gjyqtari përgjithësisht në disa raste ka disponuar me urdhër ose vendim për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes, duke caktuar seancën e parë gjyqësore në çështjet penale themeli, dhe duke pasqyruar në këtë akt urdhërimin e sekretarisë gjyqësore për kryerjen e njoftimeve të palëve ndërgjyqëse. Ndërsa në disa çështje/ kërkesa penale mungon urdhri/ vendimi me shkrim i gjyqtarit për caktimin e datës së shqyrtimit të çështjes dhe urdhërimet e tij për njoftimin e palëve, megjithatë konstatohet se njoftimet janë bërë rregullisht dhe nuk konstatohet të ketë dështuar ndonjë seancë për shkak të mosnjoftimit të rregullt për seancën gjyqësore.

Në disa çështje civile me palë kundërshtare, gjendet vendimi i gjykatës për caktimin e seancës përgatitore, e cila përmban urdhërimin e sekretarisë për planifikimin e seancës përgatitore dhe urdhërimin e njoftimit të palëve për këtë datë, por edhe ai nuk është i plotë në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, si para ndryshimeve të tij, duke urdhëruar njoftimin e kërkesë padisë dhe provave që ka paraqitur pala paditëse, palës së paditur, dhe një fakt i tillë ka sjellë që edhe njoftimet të mos jenë të plota në përmbajtjen e tyre. Në rastet kur çështja është kaluar në seancë përgatitore, mungon vendimi i arsyetuar i gjyqtarit për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Ndërsa në disa çështje të regjistruara pas hyrjes në fuqi të ligjit nr. 38/2017 që solli ndryshimin e Kodit të Procedurës Civile, rezulton se gjyqtari nuk ka disponuar me

urdhër apo vendim për kryerjen e veprimeve paraprake, caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore sipas kriterëve të parashikuara në K.Pr.Civile, duke mos urdhëruar njoftimin e kërkesë padisë, provave, duke e njohur palën e paditur për të paraqitur deklaratë mbrojtje duke përcaktuar në urdhrin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore edhe provat që do të shqyrtohen në gjykim, si dhe duke ia njoftuar urdhrin palëve pjesëmarrëse në gjykim, sidomos palëve që kanë qenë në mungesë. Vetëm në një çështje konstatohet se megjithëse mungon urdhri për kryerjen e veprimeve paraprake dhe më pas caktimin e seancës përgatitore apo gjyqësore, gjyqtari i ka njoftuar palës së paditur të drejtën për të paraqitur deklaratën e mbrojtjes. Në ato çështje ku ndodhet vendimi për caktimin e seancës gjyqësore apo përgatitore, mungojnë elementët e nevojshëm që ky vendim të jetë i plotë sipas kriterëve të përcaktuar në K.Pr.Civile.

Në çështjet penale themeli, konstatohet se gjithmonë gjykata ka vënë dosjen në lëvizje sikundër parashikohet në nenin 332 të K.Pr.Penale për çështjet e kategorisë seancë paraprake me objekt dërgimin e çështjes në gjyq, ndërkohë në çështjet penale të themelit në respektim të nenit 333/1 të K.Pr.Penale. Por siç u theksua më lart, në disa çështje kërkesa penale, mungon urdhri apo vendimi me shkrim i gjyqtarit për caktimin e seancës gjyqësore.

Në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari përgjithësisht ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore duke caktuar seancën, si dhe ka treguar kujdes maksimal për marrjen e masave për njoftimin e palëve. Megjithatë rezulton se jo çdo veprim procedural i kryer nga gjyqtari është i dokumentuar, pasi mungojnë vendimet për kryerjen e veprimeve paraprake, për caktimin e seancës përgatitore dhe gjyqësore në të gjitha çështjet dhe në ato raste kur ata janë nuk janë të plota në përputhje me kriteret ligjore.

Në lidhje me njoftimit, nga përmbajtja e tyre, konstatohet se ato nuk janë të plota në raport me të gjitha kërkesat procedura, konkretisht nuk përcaktohet lloji i seancës në të cilën do të paraqitet. Gjithashtu, nuk rezulton që së bashku me njoftimi gjyqtari të ketë urdhëruar dhe njoftuar kërkesë padinë dhe provat në respektim kriterëve ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile si përpara ndryshimeve, ashtu edhe pas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 38/2017. Megjithatë nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve, siç e theksuam më sipër.

Drejtimi i procesit gjyqësor përgjithësisht ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligj (nenet 171 e vijues të K.Pr.Civile) ashtu edhe në çështjet penale (nenet 341 e vijues të K.Pr.Penale) apo sipas ritit të gjykimit, etj.

Megjithatë në disa çështje, gjyqtari nuk është i qartë për palët për momentin procedural ku ndodhet gjykimi, pra nëse çështja është në seancë gjyqësore apo përgatitore. Ndërsa në çështjet familjare gjyqtari në disa raste nuk është i qartë për zhvillimin e seancës së pajtimit sipas nenit 134 e 135 të Kodit të Familjes, zhvillimi i të cilës është tepër i domosdoshëm në këto gjykime, si dhe për momentin procedural ku ndodhet gjykimi, nëse çështja ndodhet në veprimet përgatitore apo gjyqësore. Kjo ka sjellë që nga aktet, procesverbalet e seancës të mos dalë i qartë momenti procedural kur caktohet eksperti, që sipas rregullave të parashikuara nga neni 158/b, duhet të caktohet në seancë përgatitore. Në shumicën e çështjeve civile apo familjare, gjyqtari nuk konstatohet se shpall trupin gjykues. Ndërsa të gjitha momentet e tjera procedurale përgjithësisht zhvillohen sipas procedurave të parashikuara në ligj.

Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relatimin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit apo të paditurve, por mungon shpallja e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar, dhënien e fjalës palëve për parashtrimin dhe paraqitjen e fakteve dhe të provave, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese. Drejtimi i seancës zhvillohet në përgjithësi nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes. Gjithashtu rezulton që përgjithësisht gjykata ka disponuar me vendime të ndërmjetme mbi çdo kërkesë të parashtruar nga palët në gjykim apo edhe vendimet e ndërmjetme të marra kryesisht si ato për marrjen e provave nga të tretë apo kryerjen e aktit të ekspertimit teknik.

Në dosje te vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me

një vonesë më pak se 15 minuta, por në dy seanca kjo vonesë ka qenë më e lartë, por nuk ka sjellë asnjëherë moszhvillimin e seancës.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, mbajtur me regjistrim audio si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretaria gjyqësore.

Në Formularin e Integruar të Vlerësimit gjyqtari e ka vlerësuar në nivelin shumë të lartë, por pa dhënë shpjegime.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë aftësie mesatare në këtë tregues, evidentuar përgjithësisht në shpejtësinë dhe korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit të seancave përgatitore apo gjyqësore, duke respektuar përgjithësisht standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur përgjithësisht me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil. Por nuk konstatohet i njëjti kujdes nga gjyqtari në raport me kryerjen dhe dokumentimin e veprimeve procedurale sipas rregullave procedurale të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile, që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimeve përgatitore efektive dhe në kohë, duke marrë parasysh njoftimin e akteve apo deklaratës së mbrojtjes, planifikimi dhe zhvillimi i seancave përgatitore efektive, dokumentimi i vendimeve dhe veprimeve të tjera procedurale apo me ndjekjen me rigorozitet e fazave në të cilat kalon shqyrtimi gjyqësor, të cilat paraqitet me shumë probleme.

Pas analizës së të dhënave për këtë tregues, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “nën mesatare” duke e pikëzuar me 8 pikë.

2.C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore.

2.C.a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik, rezulton se aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Pavarësisht se nuk ka një rregullim që të përcaktojë në mënyrë të shprehur mënyrën e renditjes së akteve në dosjen gjyqësore, renditja duhet të jetë e tillë që të lehtësojë aksesimin e saj. Në këtë kuptim përgjithësisht renditja ka filluar me aktet që kanë vënë në lëvizje gjykatën, aktet e paraqitura nga palët para fillimit të seancave, veprimet dhe vendimmarrjet e gjykatës.

Në tërësi, rezulton se renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë dhe ndjek rendin logjik (sipas kategorisë) dhe kronologjike (brenda së njëjtës kategori aktesh), është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të aksesueshme. Dosjet gjyqësore paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numërtuar dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

Bazuar në sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.C.b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, të pasqyruara në Raportin Analitik rezulton se në dosjet e përzgjedhura me short, është përfshirë vetëm dokumentacioni që i ka shërbyer zhvillimit të procesit gjyqësor konkret, duke filluar nga momenti i shortimit deri në dhënien e vendimit përfundimtar (njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance përgatitore apo gjyqësore, vendimet për caktimin e seancave gjyqësore në ato raste kur është, vendimet e ndërmjetme të arsyetuara, vendimet gjyqësore) si dhe aktet e paraqitura nga palët (kërkesë padia).

Në dosjet penale nuk rezulton të jetë administruara kopje e “Letrës së të drejtave”, e cila i bashkëlidhet njoftimit për të pandehurin, personit nën hetim apo të dëmtuarit nga vepra penale, ndërkohë që komunikimi me shkrim i saj, bashkëlidhur njoftimit për seancën gjyqësore, parashikohet në mënyrë të shprehur në nenet 34/a, 58, 140, 137 i K.Pr.Penale. Pavarësisht se të drejtat e parashikuara nga këto nene, subjekteve i janë garantuar, duke ju bërë me dije edhe gjatë zhvillimit të gjykimit, mosadministrimi i kopjes me shkrim të këtij akti, bashkëlidhur kopjes së njoftimit që administrohet në dosjen gjyqësore, përbën një të dhënë që duhet vlerësuar në drejtim të plotësisë së dokumentacionit të dosjes.

Gjithashtu, në çështjet civile të regjistruar pas ndryshimeve të Kodit të Procedurës Civile, mungon akti informimit për palën e paditur, për përmbajtjen e nevojshme të deklaratës së mbrojtjes, sipas pikave 3 dhe 4, të nenit 158 të K.Pr.Civile, në lidhje me mundësinë për të kërkuar ndihmë ligjore dhe pasojat ligjore në rast moslëshimi të deklaratës së mbrojtjes njoftimin e palës së paditur. Një deklaratë e tillë apo shkresë informuese gjendet vetëm në një dosje civile.

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë mbi mesataren për këtë tregues, pasi në dosjet e vëzhguara nuk rezulton prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete apo mungesa të akteve të që lidhen me çështjen konkrete, përveç mungesës të "Letrës të të drejtave" e cila nuk rezulton të jetë administruar bashkëlidhur kopjes së njoftimeve për seancën e parë gjyqësore për të pandehurin dhe të dëmtuarin nga vepra penale në dosjet penale të përzgjedhura me short për vlerësim si dhe mungesa e aktit informues për palën e paditur lidhur me përmbajtjen e deklaratës së mbrojtjes.

Sa më sipër, vlerësoj se aftësia e gjyqtarit për këtë tregues është “mbi mesatare”, duke e pikëzuar me 8 pikë.

Propozimi për kriterin e dytë të vlerësimit është 84 pikë, niveli i vlerësimit “Shumë mirë”.

Etika dhe angazhimi – lidhur me këtë tregues rezulton se është prezantuar maksimale. Konkretisht “Etika në punë”, 3.A.a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion.

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye është vlerësuar/pikëzuar me 35 pikë.

Integriteti i gjyqtarit – Për sa më sipër, referuar parimit të prezumimit dhe përcaktimeve të Metodologjisë së Pikëzimit lidhur me këtë tregues, në mungesë të të dhënave që mund të tregojnë për cenim të integritetit të gjyqtarit, vlerësoj se gjyqtari duhet të pikëzohet me pikët maksimale për këtë tregues, pasi prezumohet se ka shmangur plotësisht shfaqjen e sjelljeve të pahijshme, apo sjelljeve që cenojnë nderin dhe dinjitetin. Për këtë arsye propozohet pikëzimi i tij me 40 pikë.

Paanësia e gjyqtarit – Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve. Për këto arsye, rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese dhe propozohet pikëzimi i tij me 10 pikë.

3.C.b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit - Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është “I pakonsiderueshëm”, duke qenë se gjatë kësaj periudhe vlerësimi, janë pranuar vetëm 5 nga 24 kërkesat për përjashtimin e tij. Sa më sipër vlerësoj se lidhur me këtë tregues gjyqtari duhet të pikëzohet me 15 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për këtë kriter është 100 pikë, niveli i vlerësimit “Shkëlqyeshëm”.

Aftësia profesionale dhe angazhimi profesional.

Konkretisht, 4.A.a. Komunikimi i qartë – rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë si me palët ndërgjyqëse dhe pjesëmarrësit në proces dhe me të tretët. Për këto arsye propozohet pikëzimi i tij me 25 pikë.

4.A.b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale.

Në tërësi, nga analiza e integruar e burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari në çdo rast ka respektuar konfidencialitetin dhe të dhënat personale të palëve duke treguar aftësi të larta në drejtim të këtij treguesi. Për këtë arsye vlerësoj se aftësia e tij për këtë tregues është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Aftësia për të bashkëpunuar – Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta është shumë e lartë. Për këtë arsye propozohet pikëzimi i tij me 15 pikë.

Shkalla e komunikimit dhe e bashkëpunimit me administratën gjyqësore – edhe për këtë tregues vlerësohet se aftësia e tij është shumë e lartë, duke e pikëzuar me 10 pikë.

Sa i përket pjesëmarrjes së gjyqtarit në programet e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, ka rezultuar se gjatë periudhës së vlerësimit ka marrë pjesë në 13 (trembëdhjetë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 19 ditë trajnimi. Referuar sa më sipër vlerësoj se është brenda kufijve 15 – 120 ditë në të gjithë periudhën trevjeçare. Për këtë arsye duhet të pikëzohet me 20 pikë.

Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional – Për këtë tregues nuk rezulton angazhim i gjyqtarit. Kështu, referuar Metodologjisë së Pikëzimit për këtë tregues propozohet pikëzimi i tij me 3 pikë, pasi 2

pikë i shtohen vetëm në rast të vërtetimit të angazhimit. Në kushtet kur nuk rezulton angazhim i tij, propozohet pikëzimi me 3 pikë.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në veprimtari ndërinstitucionale. Edhe lidhur me këtë tregues, rezultoi se nuk ka të dhëna për pjesëmarrjen e tij në veprimtari ndërinstitucionale, për këtë arsye propozohet pikëzimi i tij me 3 pikë.

Publikimet ligjore – nuk rezultoi që gjatë periudhës së vlerësimit gjyqtari të ketë publikime ligjore akademike. Për këtë arsye propozohet vlerësimi i tij me 0 pikë.

Propozimi për këtë kriter vlerësimi është "Shkëlqyeshëm" me 91 pikë.

Propozimi për nivelin e vlerësimit për çdo kriter është si më poshtë:

Aftësitë profesionale të gjyqtarit, 83 pikë, "Shumë mirë".

Aftësitë organizative të gjyqtarit, 84 pikë, "Shumë mirë".

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale, 100 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Aftësitë personale dhe angazhimi profesional, 91 pikë, "Shkëlqyeshëm".

Vlerësimi i përgjithshëm është 358 pikë, niveli i vlerësimit "Shumë mirë".

Më poshtë janë bërë edhe propozimet dhe rekomandimet, të cilat nuk po i citoj.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Fjalën po e kaloj tek zoti {...}, shkurtimisht, duke qenë se relatorja në fakt mori një kohë të konsiderueshme për ta shprehur në detaj të gjithë raportin, nga ju shkurtimisht, sepse Këshilli është vënë në dijeni dhe i kemi përpara komentet tuaja. Kështu që dua që të ndaleni në ato gjëra që mund të theksoni më shumë.

{...}: Po kaloj direkt tek kriteri ku kam bërë kundërshtime, tek “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes”. Pjesa kritike këtu ka të bëjë me një vendim penal të vitit 2017, tek nënndarja “Lloji i dënimit”. Është cituar një rrethanë rënduese nga ana ime që nuk ka lidhje me çështjen, që është “vdekja”. Po ashtu është evidentuar edhe një çështje civile “Marrëdhënie pune” si pjesë kritike, që është përmendur neni 155/3, dispozitë e cila nuk ka lidhje me kontratën me afat të caktuar si dhe nuk ka lidhje me çështjen.

Në përgjigje të këtyre kritikave, për sa i përket vendimit me objekt “Marrëdhënie në punë” sqaroj se përmendja e nenit 155/3 që është pika 30 e vendimit unë e kam

përmendur për t'i treguar palës që me faktet dhe rrethanat e çështjes i takon edhe ky dëmshpërblim, por meqenëse nuk e ka kërkuar, gjykata nuk po ta njeh. Neni 155/3 ka lidhje edhe me kontratat me afat të caktuar domethënë dëmshpërblimi njihet edhe për kontratat me afat të caktuar. Unë e zbatoj në të dyja rastet, edhe kontratën me afat dhe pa afat. Kështu që gjykoj që kjo dispozitë ka lidhje me çështjen që kam gjykuar unë. E kam parë këtë kriter dhe vlerësimet janë shumë të larta për performancën e gjyqtarit. Vetëm këtu dy mangasi të papërfillta që unë i kundërshtoj dhe vlerësoj që ky kriter me 20 është vlerësuar, kërkoj bëhet 25.

Është treguesi për të interpretuar ligjin, vlerësimi është bërë me 20 pikë. Këtu kritika qëndron tek pjesa e vendimit penal që thuhet se mungon analiza individuale e gjyqtarit. Domethënë bëhet një përshkrim i fakteve të çështjes siç ka rezultuar nga prokuroria por nuk është zgjeruar gjyqtari në analizën e faktit penal.

Kundërshtimet e mia në këtë pikë janë sepse ne kemi hyrë me gjykim të shkurtuar këtu. Janë vepra penale të lehta, drejtim automjeti dhe dhunë në familje (se këto më kanë rënë në short). Për faktin penal nuk ka pasur kundërshtime dhe unë nuk jam zgjeruar në analizën e rrethanave të faktit penal dhe prandaj i kam rënë pak shkurt (jo se mungon analiza). Për shembull “drejtim automjeti” mjafton fakti që ai ka qenë në gjendje të dehur, dhe e kam lidhur me kërkesat e dispozitës dhe e kam kaluar në konkluzion. Vlerësimet janë shumë të larta edhe për këtë lloj kriteri, por në disa pika ka vërejtje dhe unë prandaj kërkoj të bëhet 25 pikë edhe ky kriter.

Treguesi “Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik”, aspekt që përshkruhet në faqen 31–34 të raportit. Vërejtjet janë shprehur në faqen 33 të raportit. Thelbi është që, këtu kritika është që gjyqtari ka një analizë të zgjeruar të dispozitave dhe dominon analiza ligjore në raport me rrethanat e çështjes. Nuk është se ka ndonjë vendim konkret. Në raport përmendet vendime që kanë rënë në short, por në cilin vendim unë kam bërë analizë të zgjeruar të dispozitave, por duke marrë parasysh faktin që mua më ka rënë në short “Lirim, dorëzim sendi”, “zgjidhjet e martesës” apo “kundërshtim veprimesh përmbarimore”... Unë jam zgjeruar pak për shembull në “padi rivendikimi” ku është trajtuar instituti i rivendikimit dhe normalisht këtu do të preken disa elementë që ndërthuren disa dispozita ligjore dhe është bërë një analizë më e gjatë për ta mbështetur më fort konkluzionin. Edhe zgjidhja e martesës ka institutet “detyrim për ushqim”,

“përgjegjësia prindërore” dhe prandaj jam zgjatur pak në analizën ligjore. Rrethanat e faktit vërtetë nuk janë të zgjeruara sepse aq është edhe natyra e çështjes. Zgjidhja e martesës i ka të shkurtra rrethanat e çështjes dhe nuk ka volum të madh rrethanash. Në tërësi edhe këtu vlerësimi është shumë pozitiv por ka disa vërejtje për pjesën që dominon analiza e tepruar teorike. Vetëm për këtë pjesë. Kështu që unë s’dua të zgjatem, vetëm se e kundërshtoj dhe kërkoj maksimalen, ose 25 pikë.

Kështu që nga "Shumë mirë" kërkoj që të më bëhet "Shkëlqyeshëm" kriteri “Aftësitë profesionale”.

Ndërsa në kriterin “Aftësitë organizative”, kundërshtime kam për “Rendimentin e përfundimit të çështjeve gjyqësore”. Jam vlerësuar me 8 pikë. Unë e kam rendimentin mbi 83%, me 10 pikë duhet ta kesh mbi 93%. Duke pasur faktin që kam gjykuar mbi 600 çështje në vit, ngarkesa e madhe, viti i parë i punës (sepse ka filluar në Pogradec), 3 veta kemi qenë gjithsej dhe e kam pasur të pamundur ta arrij këtë objektiv. 93% është e pamundur. Duhet të kesh 400 çështje që ta kalosh mbi 93. Kështu që kërkoj që rendimenti të më bëhet maksimal, nga 8 në 10 pikë. Pa u zgjatur shumë.

Ndërsa “Aftësia për të kryer veprimet e nevojshme procedurale”, këtu më janë dhënë 12 pikë, nga 20 pikë që janë në total. Këtu janë evidentuar mangësi me mungesën e urdhrave për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore. Në disa vendime ky urdhër mungon (urdhri për ta vënë dosjen në lëvizje ose urdhri për ta kaluar çështjen në seancë gjyqësore). Pra nuk janë ndjekur me rigorozitet hapat proceduralë. Unë e pranoj janë vërtetë ato. Por këto janë bërë nga ngarkesa, nga shpejtësia dhe e kemi neglizhuar pak në këtë aspekt. Megjithatë unë gjykoj që këto janë gjashtë aspekte gjithsej. Vetëm ky aspekt është me probleme, ndjekja me rigorozitet i fazave të shqyrtimit gjyqësor, ndërsa aspektet e tjera janë pozitive. Dosjet janë vënë në lëvizje në kohë (është konstatuar), njoftimet drejtuar palëve, janë realizuar në kohë, drejtimi i procesit është evidentuar në mënyrë të rregullt. Edhe kjo ka rezultuar pozitiv. Përveçse thuhet që nuk është shpallur në disa vendime përbërja e trupit gjykues. E vërtetë është edhe këtu, mund ta kem neglizhuar këtë pjesë, por kjo nuk ka sjellë pasojë se unë s’kam pasur kërkesa për përjashtim në ato momente.

Çelja e seancave gjyqësore është bërë në kohë edhe regjistrimi audio e tyre është bërë. Megjithëse këtu thuhet që nuk është bërë urdhri për vënien e dosjes në lëvizje në

disa çështje. Prapë çështjet janë zhvilluar në kohën e duhur. Nuk ka pasur vonesa. Mendoj që nga 12 pikë që më janë dhënë, të paktën të shtohen edhe 4 – 5 (16 – 17) jo të më hiqen, se 8 pikë janë shumë që të më hiqen këtu. Mund të marrë edhe 4-5 pikë më tepër.

Atëherë, në përfundim kërkoj që “Aftësitë organizative të gjyqtarit” kërkoj që nga 84 pikë që është "Shumë mirë" këtu, të bëhet "Shkëlqyer". Këto kam, nuk kam gjë tjetër. Ju faleminderit!

Vetëm diçka për të thënë, që po të kem ngarkesë të reduktuar, të kem deri në 400 po them (se deri në 400 mund t’i përballosh) unë i kuroj të gjitha vendimet, por ngarkesa e madhe... unë pothuajse 99% të vendimeve janë arsyetuar, janë dorëzuar në sekretari brenda 3 ditëve. Tension, presioni i madh ka bërë që në disa momente të cedojë në vendime dhe të mos jenë kaq të kuruara. Kaq kisha.

Naureda Llagami: Shumë faleminderit!

Mund të qëndrosh nëse kolegët mund të kenë ndonjë pyetje për sqarim më tutje.

(Nuk ka pyetje.)

Kolegët nuk kanë, kështu që faleminderit për prezencën.

Mund të vazhdosh, të largohesh, për të lejuar Këshillin që të bëjë vlerësimin.

{...}: Ju faleminderit shumë!

Punë të mbarë!

(Largohet nga salla e mbledhjes gjyqtari z. {...}).

Naureda Llagami: Duke vijuar seancën.

Përpara se të kalojmë, në radhë të parë do të doja nga kolegët, pasi dëgjuan edhe gjyqtarin, nëse kanë ndonjë propozim konkret lidhur me projektraportin. Kemi ndonjë propozim? Po, zoti Hado!

Ridvan Hado: Jam dakord me propozimin e relatores në përgjithësi. Tejtë kësaj, tek kriteri i dytë propozoj që për sa i përket “Rendimentit të përfundimit të çështjeve

gjqësore”, nga 8 pikë të shkojë në 10 pikë, për shkak se ka gjykuar mbi 600 çështje gjyqësore. Kanë qenë vetëm tre gjyqtarë në dispozicion. Në këto kushte them që i takojnë për këtë nënkategori pikët maksimale, 10 pikë. Faleminderit!

Naureda Llagami: Atëherë, siç e kemi për procedurë, fillimisht do kalojmë në propozimin e bërë nga zoti Hado dhe më pas në tërësi projektraportin. Jemi dakord me propozimin?

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Miratohet propozimi i zotit Hado me rritjen me 2 pikë, nga 8 në 10 pikë.

Atëherë, kalojmë në tërësi projektraportin i cili nuk ndryshon nivelin e vlerësimit, por ndryshon vetëm pikët, nga 358 pikë – në 360 pikë. Kalojmë në votim.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional i gjyqtarit {...}, për periudhën 2017 – 2019”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:

- A. Aftësitë profesionale – “Shumë mirë”;
- B. Aftësitë organizative – “Shumë mirë”;
- C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
- D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.

Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shumë mirë”.

2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

* * *

(Pika 8 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2023)

Pika 9 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023, të ndryshuar me vendimin nr.470, datë 26.07.2023”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Naureda Llagami* (kryetare)
2. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
3. *Klodian Kurushi* (anëtar)
4. *Fatmira Luli* (anëtare)
5. *Irena Plaku* (anëtare)
6. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
7. *Ridvan Hado* (anëtar)
8. *Alban Toro* (anëtar)
9. *Marçela Shehu* (anëtare)

10. Brikena Ukperaj (anëtare)

11. Yllka Rupa (anëtare)

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës dhe në sallë:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

7. Vladimir Karaj, BIRN.

RENDI I DITËS:

9. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023, të ndryshuar me vendimin nr.470, datë 26.07.2023”, i përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (relatore znj. Brikena Ukperaj).

Naureda Llagami: Kalojmë në çështjen tjetër të rendit të ditës e cila ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për një ndryshim në listën e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar me vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 466, datë 25.07.2023, të ndryshuar me vendimin nr.470, datë 26.07.2023”. I përgatitur nga Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe do të raportohet nga zonja Ukperaj.

Brikena Ukperaj: Faleminderit zonja Kryetare!

Shkurtimisht, duke qenë se relacioni është i detajuar.

Këshilli ka detajuar listën e gjyqtarëve udhëheqës për mentorim, ka bërë edhe shpërndarjen e kandidatëve për gjyqtarë të vitit të tretë të Shkollës së Magjistraturës pranë mentorëve përkatës për tre katërmujorët. Ndërkohë, pas marrjes së këtyre

vendimeve ka ndodhur një rrethanë e re, pasi një nga mentorët, gjyqtari {...} i ka mbaruar statusi i magjistratit për shkak të vendimit të KPA-së i cili ka vendosur shkarkimin e tij nga detyra. Në këto kushte është e nevojshme që të bëhet zëvendësimi i këtij gjyqtari me tre gjyqtarë të tjerë në secilin nga tre katërmujorët.

Komisioni ka marrë parasysh për propozimin e gjyqtarëve të rinj mentorë që do të jenë: numrin e reduktuar të mentorëve në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, si dhe numrin e lartë të kandidatëve për gjyqtarë që studiojnë në vitin e tretë të Shkollës së Magjistraturës. Kemi propozuar që për katërmujorin e parë të bëhet zëvendësimi me gjyqtarin {...}, në të cilin gjyqtari do të ketë dy mentorime për shkak se rritet numri dhe ka një numër më të vogël të gjyqtarëve mentorë; me gjyqtarin {...} në katërmujorin e dytë dhe me gjyqtaren {...} në katërmujorin e tretë. Në këtë mënyrë barazojmë pothuajse që të gjithë gjyqtarët e gjykatës administrative, pasi kanë të gjithë nga dy mentorë për këtë periudhë (mos të ngarkonim asnjë me tre mentorë). Në këto kushte është hartuar edhe projektvendimi me tre pikat përkatëse: Në pikën e parë të së cilit është parashikuar ndryshimi pjesërisht i vendimit nr. 466, i cili është ndryshuar me vendimin nr. 470, duke zëvendësuar gjyqtarin udhëheqës z. {...} me gjyqtarët {...} në sesionin e parë 4-mujor (korrik – tetor 2023) i cili do të ketë në mentorim edhe kandidaten {...}; b) {...} në sesionin e dytë 4-mujor (nëntor 2023 – shkurt 2024) të cilit i shtohet në mentorim edhe kandidati {...} dhe c) {...} në sesionin e tretë 4-mujor (mars – qershor 2024) e cila do të ketë në mentorim edhe magjistraten {...}.

Në pikën e dytë është parashikuar njoftimi i vendimit shkollës dhe gjyqtarëve respektivë, si dhe momenti i hyrjes në fuqi me botimin në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Faleminderit!

Naureda Llagami: Faleminderit!

Nëse s’kemi diskutime, kalojmë në miratim të projekt-aktit, sipas propozimit të ardhur.

Ilir Rusi: Dakord.

Irena Plaku: Pro.

Naureda Llagami: Kalojmë në votim pra, edhe një herë të lutem.

Iliri votoi, Irena!

Irena Plaku: Pro. Votova.

Dritan Hallunaj: Pro.

Ridvan Hado: Dakord.

Alban Toro: Dakord.

Fatmira Luli: Dakord.

Marçela Shehu: Dakord.

Yllka Rupa: Pro.

Brikena Ukperaj: Pro.

Klodian Kurushi: Dakord.

Naureda Llagami: Dakord.

Atëherë miratohet projekt–akti sipas propozimit të ardhur nga relatori.

Kemi çështjen me dyer të mbyllura dhe më pas kemi caktimin e gjyqtarëve që do t'i bëjmë “online”, pasi janë disa materiale të mbledhura, kështu që unë propozoj që të mbylлим edhe këtë çështje, për të lejuar më pas për çerek ore pushim për të vijuar me hedhjen e shortit “online”.

* * *

(Pika 9 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 13.09.2023)

Pika 11 e rendit të ditës me objekt: Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:07 dhe mbaroi në orën 14:31.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- | | |
|---------------------------|--------------------------|
| 1. Ilir Rusi | (zëvendëskryetar) |
| 2. Klodian Kurushi | (anëtar) |
| 3. Fatmira Luli | (anëtare) |
| 4. Irena Plaku | (anëtare) |
| 5. Dritan Hallunaj | (anëtar) |
| 6. Ridvan Hado | (anëtar) |
| 7. Alban Toro | (anëtar) |
| 8. Marçela Shehu | (anëtare) |

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje dhe çështja ishte parashikuar të trajtohej e 10-ta sipas rendit të ditës.

9. Brikena Ukperaj (anëtare)

10. Yllka Rupa (anëtare)

Shënim: Nuk mori pjesë në këtë çështje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, *znj. Naureda Llagami*.

Morën pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm.

2. Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

3. Luan Dibra, Maela Alicanaj, Rezarta Taushani, Gentiana Agushi, Këshilltarë pranë Komisioneve të Përhershme në Këshill.

4. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, Përfaqësuese e MD-së.

5. Valbona Bala, Eksperte (EWMI-INL).

6. Staf nga administrata e KLGJ-së.

7. Vladimir Karaj, BIRN.

RENDI I DITËS:

11. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

Mbledhja vijon të drejtohet nëpërmjet platformës “online” nga z. Ilir Rusi, Zëvendëskryetar i Këshillit.

Çështja e fundit e rendit të ditës lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme, për të cilën është janë përgatitur relacionet nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Fjala i jepet relatorit të çështjes z. Kurushi i cili parashtron relacionin e përgatitur lidhur me kërkesën e ardhur nga **Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të**

Përgjithshëm Kukës, e cila ka paraqitur dy kërkesa për caktimin e një gjyqtari në dy çështje penale (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohet procedurës së shortit sipas tabelës në relacion).

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Kukës, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në vijim, propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë Gjykata Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë (si gjykata më e afërt).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçantë, të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, të përjashtohet nga shorti Zv.Kryetari i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, konkretisht: z. Artan Hajredinaj.

Zonja Ukperaj bën një ndërhyrje lidhur me përfshirjen në short të z. {...}, duke qenë se ditën e sotme në mbledhje u miratua transferimi i tij. Ai sot konsiderohet gjyqtar i Gjykatës së Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; kjo referuar edhe herëve të tjera ku gjyqtarët janë përjashtuar nga shorti.

Zoti Toro merr fjalën për t'u shprehur se nuk prish punë ekzistenca e tij. Edhe në Tiranë po të jetë, nëse një gjykatë do të ketë nevojë, do të marri transferim për çështje të caktuara. Ndërkohë edhe efektet i ka më datë 20.

Ndërsa **zoti Kurushi** është i mendimit që vërtet zoti Marku aktualisht do të shkojë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Është menduar që për sa kohë ka një afat deri

82

më datë 20.09, ai do të vazhdojë funksionin si gjyqtar i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë. Ndodhur në këto kushte nuk ka pse të përjashtohet, sepse bëhet edhe më efektiv shorti duke iu referuar që janë dy çështje dhe për të dy çështjet kërkohen 2 gjyqtarë. Për sa kohë aktualisht deri më datë 20 ai do vazhdojë të ushtrojë funksionet pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, zoti Kurushi është i mendimit që mos të përjashtohet nga shorti.

Zonja Ukperaj nuk ka kundërshtime të tjera për sa kohë Komisioni e vlerëson të mos përjashtohet nga shorti.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë më diskutime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1 dhe nr. 2, penale (kërkesat me nr. 648 dhe 684), gjyqtari Aurel Arapi.

Parashtrohet relacioni i përgatitur lidhur me kërkesën e ardhur nga **Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë**, e cila ka paraqitur një kërkesë për caktimin e një gjyqtari në një çështje penale (lexohen të dhënat e çështjes që do t'i nënshtrohet procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët {...} dhe {...}. Gjyqtari {...} dhe {...} kanë dhënë vendimin për rishikimin e vendimit penal për këtë të pandehur.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në vijim, propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër (seksioni penal).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të jetë 1(një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, të përjashtohen nga shorti kryetari në detyrë i gjykatës së Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, konkretisht: z. {...} dhe z. {...}, për shkak të procesit të rivlerësimit në KPA.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime apo diskutime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale (kërkesat me nr. 129), gjyqtari Tonin Sterkaj..

Parashtrohet relacioni i përgatitur lidhur me kërkesën e ardhur nga **Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Berat**, e cila ka paraqitur një kërkesë për caktimin e një gjyqtari në një çështje penale (lexohen të dhënat e çështjes që do t'i nënshtrohet procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët {...} dhe {...}. Gjyqtarja {...} ka gjykuar të bashkëpandehurin. Matilda Llangozi është gjyqtare e hetimit paraprak. Gjyqtari {...} ka gjykuar kërkesën për caktim mase sigurimi.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në vijim, propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për

gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë penale, të jetë Gjykata e Shkallës së parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier (seksioni penal).

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështje gjyqësore të veçantë penale të jetë 1 (një).

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Të përjashtohet nga shorti zëvendëskryetarja e gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, konkretisht: znj. Olkeda Lice.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime apo diskutime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale (kërkesat me nr. 689), gjyqtari Alfred Konomi.

Parashtrohet relacioni i përgatitur lidhur me kërkesën e ardhur nga **Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (relacion i përditësuar)** e cila ka paraqitur dy kërkesa për caktimin e një gjyqtari në dy çështje penale që ndodhen në seancën e fazës paraprake (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohet procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Për çështjen e parë trupi gjykues përbëhet nga gjyqtarët {...} dhe {...}; Gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë kryer veprime paraprake për procedimin penal në ngarkim të të pandehurve {...} etj; Trupi gjykues i përbërë nga {...}, {...} dhe {...} kanë në gjykim themeli çështjen nr. 73 akti, në ngarkim të të pandehurve {...} etj; Gjyqtare {...} ka dhënë vendimin e seancës paraprake dhe ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim në ngarkim të të pandehurve {...} etj. Për çështjen e dytë kanë pengesë gjyqtarët e gjykatës – {...} të cilës i është pranuar kërkesa për heqje dorë pasi është anëtare e trupit gjykues së bashku me {...} dhe {...}, në çështjen me të pandehur {...} dhe {...}. Gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë kryer veprime në dosjen penale në ngarkim të të pandehurve {...} , {...} etj. Gjyqtarët {...} dhe {...}, kanë kryer veprime paraprake për procedimin penal ndaj të pandehurit {...} etj; Gjyqtarët {...}, {...} dhe {...} kanë dhënë vendim në ngarkim të të pandehurve në procedim të lidhur me të pandehurin {...} etj.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së

delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në vijim, propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 2 (dy) çështjeve gjyqësore të veçanta të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 2 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 2.

Për 2 (dy) çështje, për të cilat kërkohet nga 1 (një) gjyqtar, të përzgjidhen me short 2 të tillë, ndërmjet gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret si më lart.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar relacionit më sipër. Bashkëlidhur gjendet edhe lista e gjyqtarëve që plotësojnë të gjitha kriteret ligjore të përmendura më lart për të shqyrtuar kërkesat e parashtruara nga kjo gjykatë.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime apo diskutime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjet nr. 1, penale (kërkesa nr. 2116), gjyqtarja e përzgjedhur Esmeralda Xhili.

Për çështjet nr. 1, penale (kërkesa nr. 2312), gjyqtari i përzgjedhur Paulin Çera.

Me shqyrtimin e kësaj çështjeje, mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor